

The CHwB projects are mainly financed by Swedish International Development Agency



Cultural Heritage without Borders Sweden / Kosovo office
address: Payton City Str. R. Zogovic, 8
10000 Prishtina, Kosovo
office phone/fax: +381 (0)38 243 918
e-mail: kosovo@chwb.org
web: www.chwb.org
www.chwbkosovo.org




CHwB Kosovo Office
Report Series 18 / 2011

Projekte të Konservimit të Integruar në Komunën e Junikut

Integrated Conservation projects in Junik Municipality



7 Projekte të Konservimit të Integruar në Komunën e Junikut
Integrated Conservation projects in Junik Municipality



RESTAURIMI I KULLËS ODA E JUNIKUT
RESTORATION OF KULLA ODA E JUNIKUT

PLANI I KONSERVIMIT DHE I ZHVILLIMIT PËR JUNIKUN
JUNIK CONSERVATION AND DEVELOPMENT PLAN

DOKUMENTI I INTEGRUAR I VIZIONIMIT PËR JUNIK
INTEGRATED DOCUMENT OF VISIONING FOR JUNIK

PLANI ZHVILLIMOR URBAN JUNIK 2023+
URBAN DEVELOPMENT PLAN JUNIK 2023+

PLANI RREGULLATIV URBAN QENDRA E JUNIKUT
URBAN REGULATIVE PLAN CENTER OF JUNIK

A ËSHTË JUNIKU UNIK?
IS JUNIK UNIQUE?

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL 2010 - 2023
MUNICIPAL DEVELOPMENT PLAN 2010 - 2023



CH
WB
Cultural
Heritage without Borders
KULTURARV UTÄN GRANSER

Ky publikim përmban ekstrakte nga dokumentet origjinale të 7 projekteve të realizura në Junik. Për tu pajisur me versionet e plota të projekteve, mos hezitoni të kontaktoni institucionet bartëse të çdo projekti apo edhe në adresat që gjenden në ballinën e pasme të publikimit.

This publication contains extracts from original documents of 7 projects conducted in Junik. To obtain the full version of these projects, do not hesitate to contact responsible institutions for each project or in the addresses found on the back cover of this publication.



**Mirësevini në Kullat e Junikut,
Freskohuni me ujin e Erenikut,
Pushoni në Moronicë,
Ngjitetuni në Gjeravicë.**

(Logo dhe moto e përbashkët nga Punëtorja e Vizionimit për Junik, 2007)

**Welcome to the Kullas of Junik,
Refresh with the water of Erenik,
Rest in Moronica,
Hike to Gjeravica.**

(Joint logo and motto from Visioning Workshop for Junik, 2007)

* Junik, really unique



PËRMBAJTJA	006-007
JUNIKU, NJË FILLIM I MBARË... nga Sali Shoshi	008-009
JUNIKU, NJË TREGIM I SUKSESSHËM... nga Enes Toska	010-011
1. RESTAURIMI I KULLËS ODA E JUNIKUT	012-015
2. PLANI I KONSERVIMIT DHE I ZHVILLIMIT PËR JUNIKUN	016-059
3. DOKUMENTI I INTEGRUAR I VIZIONIMIT PËR JUNIK	060-075
4. PLANI ZHVILLIMOR URBAN JUNIK 2023+	076-103
5. PLANI RREGULLATIV URBAN QENDRA E JUNIKUT	104-133
6. A ËSHTË JUNIKU UNIK?	134-149
7. PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL 2010 - 2023	150-239
VETËM 7 NUK MJAFTOJNË...	240-241
EKIPI REALIZUES I PUBLIKIMIT	242

006-007	CONTENT
008-009	JUNIK, AS A GOOD START... by Sali Shoshi
010-011	JUNIK, A SUCCESS STORY... by Enes Toska
012-015	1. RESTORATION OF KULLA ODA E JUNIKUT
016-059	2. JUNIK CONSERVATION AND DEVELOPMENT PLAN
060-075	3. INTEGRATED DOCUMENT OF VISIONING FOR JUNIK
076-103	4. URBAN DEVELOPMENT PLAN JUNIK 2023+
104-133	5. URBAN REGULATIVE PLAN CENTER OF JUNIK
134-149	6. IS JUNIK UNIQUE?
150-239	7. MUNICIPAL DEVELOPMENT PLAN 2010 - 2023
240-241	7 IS NOT ENOUGH...
242	PUBLICATION TEAM

JUNIKU, NJË FILLIM I MBARË...

Shtetet janë të varfëra jo pse nuk kanë resurse por sepse nuk i shfrytëzojnë ato (Më shumë urban, më pak të varfër, Publikim i Sida-s 2006)

Nëse të zë nata në Junik duhet të gjesh konak te Konaku i Ramë Zyberit, një kullë e vjetër e adaptuar për pritje të misafirëve në modelin Fjetje dhe Mengjes, i njohur në botë si Bed & Breakfast. Kjo është një ndër gjashtë kullat të cilat janë restauruar në Junik që nga viti 2001, disa të mbështetura nga donacionet ndërsa disa të tjera nga iniciativat private. E fundit në vargun e restaurimeve është kulla në Lagjën Berishë e cila do të shndërrohet në Qendrën Turistike Regjionale *Shihemi n'Dukagjin*, një projekt që ka për synim krijimin dhe plasimin në treg të produktit turistik të Junikut dhe komuave fqinje.

Mbrojtja e trashëgimisë dhe zhvillim lokal i komunitetit përmes turizmit kulturor (Programi i CHwB-së 2008-2011)

E gjitha filloi në vitin 2001, në një kontekst ku trashëgimia kulturore nuk ishte prioritarë ndaj përmbushjes së nevojave primare të rindërtimit të shtëpive të djegura, me pak fjalë, rikthimit të jetesës normale. Pikërisht në këtë vit, me një fond të Komisionit Evropian dhe Agjencionit Suedez për Zhvillim Ndërkombëtar, Sida, fondacioni suedez Trashëgimia Kulturore pa Kufij, restauroi Kullën e njohur si Oda e Junikut, një “institucion” kanunor për zgjidhjen e problemeve shoqërore në shekujt kur ky regjion dhe e gjithë Kosova ishte nën pushtimin Osman. Shumë organizata dhe pronarë të tjerë në Junik dhe në vise të tjera të Kosovës u motivuan që të investojnë në mbrojtjen e shtëpive tradicionale. Më tutje, bashkëpunimi i CHwB vazhdoi me administratën e Komunës së posaçmërisht të Junikut. Të motivuar, ata bënë çdo gjë që është e mundur që trashëgiminë kulturore ta vënë në qendër të zhvillimit ekonomik të komunës së tyre. Të gjitha dokumentet strategjike të hartuar gjatë këtyre viteve nga komuna dhe nga partnerët e saj u inspiruan nga trashëgimia natyrore dhe kulturore e Junikut.

Trashëgimia kulturore e integruar në planifikim hapësinor dhe urban në nivel komunal dhe qendror (Programi i CHwB-së 2008-2011)

Një listë e gjatë e arkitektëve, urbanistëve, mjeshtrëve, studentëve, OJQ-ve, zyrtarëve institucionalë, komunitetit ishin pjesë të realizimit të projekteve.

Të gjithë kanë dhënë nga pak nga dija, përvoja dhe vullneti i tyre. Gjithashtu, të gjithë kanë përfitur duke u bërë pjesë e një rrjeti të gjërë të njëzëve të vullnetit të mirë që kanë për synim ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Kosovës si pjesë e mozaikut evropian dhe botëror. Mjeshtërt e angazhuar në punët restauruese në projektet e CHwB janë tashmë të dëshmuar si mjeshtërt të kualifikuar edhe në nivel regional. Ata kanë udhëhequr punët në Kampin e Restaurimit në Gjirokastër (Shqipëri) gjatë 4 edicioneve të fundit.

Ndërtim i kapaciteteve - fuqizimi i kompetencës dhe njohurive rreth teknikave dhe materialeve tradicionale për institucionet lokale, ndërrmarësit dhe sektorin e edukimit (Programi i CHwB-së 2008-2011)

Komuna e Junikut sot është i vetëdijësuar për rolin në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Për dallim prej shumë komunave të tjera të Kosovës, ata kanë ndarë një buxhet të konisderushëm për renovimin e shtëpive tradicionale. Njëkohësisht stafi komunal është duke konkuruar edhe në projekte të tjera të cilat kanë për qëllim zhvillimin lokal përmes përmirësimit të infrastrukturës. Derisa i shkruaja këto rreshta, një pronar i një kulle në Junik me mjete vetanake ka filluar renovimin e kullës së vet. Kjo është inkurajuese.

...forcimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të institucioneve demokratike, zhvillim i qëndrueshëm dhe i balancuar, dhe implementimi i standardeve dhe vlerave Evropiane përmes integritetit të Kosovës në një kulturë më të gjërë Evropiane (Programi i CHwB-së 2008-2011)

Juniku është në fillimet e veta. Rruga është ende e gjatë dhe shumë punë është para nesh. Juniku nuk është i ndarë nga zhvillimi i Kosovës dhe i rajonit. Megjithatë, ky fillim i mbarë është inkurajues për të konkluduar që Juniku është duke e vendosur një gur në murin e zhvillimit të Kosovës. E nëse dëshironi ta kaloni një fundjavë të paharruar në bjeshkët e Junikut, e të ngjiteni në majën e Gjeravicës, më të lartën në Kosovë, atëherë lajmërohuni te Shoqata e Bjeshkatarëve, Rrasa e Zogut. Aventura nuk do të mungojë...

*Sali Shoshi
Drejtor i CHwB zyra në Kosovë
Gusht 2011*

JUNIK, AS A GOOD START...

States are poor not because they have no resources but because they do not use them (More urban less poor, Sida publication 2006)

If you find your self in Junik at night you should find a place to stay at Ramë Zyber Guest house, an old *kulla* adapted for reception of guests in the model of Bed & Breakfast. This is one of the six *kullas*, which were restored in Junik since 2001, some supported by donations and others by private initiatives. The last verse of the restoration is in the Berisha neighborhood which will become a Regional Tourism Center *See you in Dukagjini*, a project aimed at creating and placing on the market the tourism products of Junik and neighboring municipalities.

Heritage preservation and local community development through cultural tourism (CHwB Program 2008-2011)

It all began in 2001, in a context where cultural heritage was not a priority compared to the needs of reconstruction of the burned houses, in short, the return to normal life. Just this year, with a fund of the European Commission and the Swedish International Development Agency, Sida, the Swedish foundation Cultural Heritage without Borders, restored the *kulla* known as Oda e Junikut as canon “institution” for solving social problems through the centuries when the region and the whole country was under Ottoman occupation. Many organizations and other owners in Junik and in other areas of Kosovo were motivated to invest in the protection of traditional houses. Furthermore, cooperation of CHwB continued adminsitration of the newly formed municipality of Junik. Being motivated, they did everything possible to put cultural heritage at the center of economic development of their municipality. All the strategic documents produced during these years by the municipality and its partners were inspired by the natural and cultural heritage of Junik.

Cultural Heritage integrated in urban and spatial planning on municipal and central level (CHwB Program 2008-2011)

A long list of architects, urban planners, craftsmen, students, NGOs, institutional officials, and community were part of the projects implementation. They all have

given a bit of knowledge , experience and their will. Also, all have benefited by becoming part of a wider network of people of a good will, aimed at preserving cultural and natural heritage in Kosovo as part of European and global mosaic. Craftsmen engaged in restoration works of the CHwB projects are already proven as skilled craftsmen at the regional level. They have led the work at the Restoration Camp in Gjirokastra (Albania) during the last 4 editions.

Capacity building - strengthening the competence and know-how about traditional techniques and material for local institutions, enterprises and educational sector (CHwB Program 2008-2011)

Municipality of Junik today is aware of the role in the protection and promotion of cultural heritage. Unlike many other municipalities in Kosovo, they have allocated a considerable budget on the renovation of traditional houses. At the same time municipal staff have applied in other projects aiming for local development by improving the infrastructure. While I was writing these lines, an owner of a tower in Junik with his own resources has started the renovation of his tower. This is encouraging.

...strengthening and developing the capacities of the democratic institutions, balanced and sustainable development, and implementation of European values and standards through integration of Kosovo into a wider European culture (CHwB Program 2008-2011)

Junik is in its infancy. The road is still long and much work is ahead. Junik is not separate from the development of Kosovo and the region. However, this good start is encouraging and concluding that Junik is setting a stone on the wall of Kosovo development. And if you want to spend an unforgettable weekend in the mountains of Junik, to climb to the top of Gjeravica, the highest in Kosovo, then call the mountaineering association “Rrasa e Zogut”. You will not miss the adventure....

*Sali Shoshi
Director of CHwB office in Kosovo
August 2011*

JUNIKU, NJË TREGIM I SUKSESSHËM...

Ideja e një publikimi për Junikun ka qenë e kahmotshme dhe rastisi që në 10 vjetorin e zyrës së CHwB në Kosovë dhe njëkohësisht edhe në 10 vjetorin e projektit të saj të parë në Junik, ai i restaurimit të kullës së Odës së Junikut, ta gjejë dritën edhe ky *best of* nga përvojat e CHwB bashkë me Komunën e Junikut dhe të partnerëve të vet. Ky publikim hapet me projektin e Restaurimit të Kullës së Odës së Junikut dhe mbyllet me Planin Zhvillimor Komunal, një nga dokumentet me rëndësi të madhe për zhvillimin e ardhshëm të Junikut, gjë që koïncidoi edhe me aprovimin zyrtar të këtij dokumenti në Asamblenë e Kuvendit Komunal, hiç më pak se në fund të Korrikut 2011.

Ky publikim botohet në kuadër të Programit të Konservimit të Integruar të CHwB. Qëllimi i përgjithshëm i programit është të kontribuojë në forcimin e rolit të institucioneve në integrimin e trashëgimisë kulturore në proceset e planifikimit hapësinor dhe urban në Kosovë, si dhe trajtimit të trashëgimisë si një faktor zhvillimi social. Planifikimi konzervues, si një trend global është një fushë që zhvillohet me shpejtësi e që ka mundësuar kalimin nga modeli *ad hoc* i mbrojtjes në një planifikim sistematik përfshirë strukturën, procesin gjithpërfshirës dhe ruajtjen e biodiversitetit. Kohët e fundit, vëmendja e planifikimit konzervues është përqendruar në përfshirjen e realiteteve socio-ekonomike, e sidomos në aspekt të minimizimit të shpenzimeve të menaxhimit dhe kostos së projekteve.

Si një nga personat më të kyqur nga zyra jonë në projektet e implementuara në Junik, më duhet të pranoj se këto vite mund të përkufizohen si tregim i sukseshëm dhe shumë i veçantë. E dini pse? Ja disa nga arsyt: Mbi të gjitha kemi të bëjmë me një komunë që është e bekuar me pasuri natyrore dhe kulturore; edhe pse duket që gjindet në një cep të Kosovës ajo ka qasje në trekëndëshin kufitar me dy shtete fqinje; kryetari i komunës përzgjedh një kullë si seli për pritje

të misafirëve zyrtarë; projektet nuk pësojnë apo zhagiten edhe pse nga zgjedhjet lokale ndërrojnë strukturat politike, gjë që rrallë ndodhë në pjesët tjera të Kosovës; në Planin Zhvillimor Komunal të sapoaprovuar, për herë të parë në Kosovë hartohet edhe Raporti i Vlerësimit të Ndikimit të Mjedisit; kostot e projekteve të hartuara janë më të vogla në krahasim me “çmimet e tregut” falë përkushtimit të madh të një stafi të vogël të komunës por me një motivacion shumë të madh duke mos anashkaluar edhe hapjen ndaj donatorëve; Komuna ndan eksperiencat e veta në një platformë ndërkombëtare urbane rreth qasjes së vet të planifikimit hapësinor, etj, etj, etj...

Sa i përket përmbajtjes së këtij publikimi më duhet tju njoftoj se ajo përmban ekstrakte nga 7 projektet e cekura në rend kronologjik dhe këto paraqesin një pjese shume të vogël të asaj që është punuar. Nga një total i përafërt i 1000 faqeve dokumentacion jemi munduar të bëjmë një 250 faqësh reprezentativ. Me përkushtim maksimal, jemi përkujdesur që të nxjerrim në pah ato pjesë dhe momente që kanë qenë më të spikatura gjatë këtyre viteve të implemetimit. Kërkojmë ndjesë nëse na ka ikur ndonjë detaj dhe me këtë rast ju ftojme të gjithë të interesuarve të paisen me të gjitha dokumentet në verzionet e tyre të plota.

Në fund një falenderim të sinqertë për kontributet e të gjithë kolegëve të mi në CHwB, UN-HABITAT zyra në Kosovë, Universitetin Polis dhe kompaninë Metropolis nga Tirana (Shqipëri), Institutin për Planifikim Hapësinor pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe gjithë institucioneve tjera të përfshira në proces, duke mos i harruar edhe ata më të rëndësishmit, qytetarët e Junikut dhe përfaqësuesit e Komunës së Junikut për mikëpritjen, dashamirësinë, vullnetin e madh dhe entuziazmin...

Enes Toska
Program Menagjer në CHwB zyra në Kosovë
Gusht 2011

JUNIK, A SUCCESS STORY...

The idea of a publication for Junik has been old enough and it happened just in time of the 10th anniversary of CHwB office in Kosovo and at the same time in the 10th anniversary of its first project in Junik, the restoration of *Kulla* Oda e Junikut, that this *best of* of CHwB experiences with Junik municipality and its partners found its light. This publication opens with the Restoration of *Kulla* Oda e Junikut and closes with the Municipal Development Plan, a document of great importance for the future development of Junik, which also coincided with the official approval of this document at the Municipal Assembly, not later than the end of July 2011.

This publication is published within the Integrated Conservation Program of CHwB. The overall objective of the programme is contribution to strengthening the role of institutions in integration of cultural heritage in the spatial and urban planning process in Kosovo as well as treating cultural heritage as a development factor for society. Conservation planning as a global trend is a rapidly evolving field that has enabled a transition from *ad hoc* protection to systematic planning involving pattern, inclusive process and biodiversity persistence. More recently, attention has been focused on incorporating socio-economic realities into conservation planning, particularly in terms of minimizing the management and opportunity costs of the projects.

As one of the most involved person from our office in the projects implemented in Junik, I must admit that these years can be defined as a successful story and very special. Do you know why? Here are some of the reasons: above all we are dealing with a municipality which is blessed with natural and cultural wealth; although it appears that it is found in the corner of Kosovo it has access to the border triangle with the two neighboring states; the Mayor selects a *kulla* as the main office for the reception of official guests; projects have not suffered

consequences or are even delayed when the local elections change their political structure, which rarely occurs in other parts of Kosovo; in the newly approved Municipal Development Plan for the first time in Kosovo is drafted the Environmental Impact Assessment; project costs are lower compared to “market prices” thanks to the great dedication of a small number of municipal staff but with a great motivation by not overlooking their openness to donors ; municipality shares its experiences in an urban international platform on its approach to spatial planning, etc, etc, etc...

Regarding the content of this publication I should inform you that it contains extracts from 7 mentioned projects listed in chronological order and these represent a very small part of what was done. By a rough total of 1000 pages of documentation we have tried to do a 250 page representation. With the utmost devotion, we made sure to point out those parts and moments that were most prominent during these years of implementing. We apologize if we have left any details and hereby invite all of you concerned, to obtain all the documents in their full versions.

Finally a sincere thanks to the contributions of all my colleagues in CHwB, UN-HABITAT office in Kosovo, the Polis University and Metropolis Company from Tirana (Albania), Institute for Spatial Planning within the Ministry of Environment and Spatial Planning including all other institutions involved, and not forgetting those most important, citizens of Junik and representatives of Junik municipality for the hospitality, kindness, great willingness and enthusiasm...

Enes Toska
Program Manager at CHwB, office in Kosovo
August 2011

STAFI I PROJEKTIT TË RESTAURIMIT TË 5 KULLAVE
PROJECT TEAM ON RESTORATION OF 5 KULLAS

Arkitektët/Architects

Shqipe Nixha – profesoreshë në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Arkitekturës / professor at the University of Prishtina, Faculty of Architecture

Flamur Doli – profesor në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Arkitekturës / professor at the University of Prishtina, Faculty of Architecture

Masar Gafurri – NP Coning, Pejë/ Pec

Gani Gashi – Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës / Institute for Protection of Monuments in Kosovo

Ekipi menaxhues i CHwB / CHwB Project Management Team

Dick Sandberg – Koordinator ndërkombëtar i projektit, me përgjegjësi të plotë për tërësinë e projektit / International Project Coordinator, with total responsibility for all parts of the whole project

Sezair Gafurri – Menaxher projekti, përgjegjës për menaxhimin e punëve të restaurimit në terren / Project Manager, responsible for the management of the restoration works on site

Sali Shoshi – Manaxher projekti, përgjegjës për menaxhimin e materialeve tradicionale dhe mjeshtërive / Project Manager, responsible for the management of the traditional materials and craftsman

Vjollca Aliu – CHwB dhe më vonë Departamenti i Kulturës, përgjegjëse për rregullativat e mbrojtjes së kullave / CHwB and later department of Culture, responsible for protection regulations connected to the Kullas

Naim Uka – kontrollues financiar, përgjegjës për buxhetin / Financial Controller, responsible for budgeting

Arbëresha Dedinja - Asistente e ekonomisë / Economy assistant

Bujar Prestreshi – përgjegjës për mbajtjen e ekspozitës së kullave / Responsible for the production of the Kulla Exhibition

Gjihthashtu të involvuar thellë në projekt / Also deeply engaged in the project

Gjejlane Hoxha - Departamenti i Kulturës, «Mentor» për CHwB dhe Projektin e Kullave / Department of Culture, «Mentor» for CHwB and the Kulla Project

Michael Doyle - ish-Drejtori i Departamentit të strehimit, AER/BE / ex-Head of the Housing department, EAR/EU

Dan Philpott - Drejtori i Departamentit të strehimit, AER/BE / Head of the Housing department, EAR/EU

Gazmend Selimi - Departamenti i strehimit, AER/BE / Housing department, EAR/EU

Fejaz Drançolli - Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës, Mbikqyrës Antikitetesh / The Institute for Protection of Monuments in Kosovo, Antiquarian Supervisor

Kersti Berggren - CHwB, e kyqur në rregullativat dhe ligjet për mbrojtjen ndërlidhur me Kullat / CHwB, engaged in protection regulations and laws connected to the Kullas

Shkelzen Shehu - Përfaqësues i Komunës së Deçanit / Representative of the Municipality of Decan

Mirlinda Ibishaga Cena - Përfaqësuese e Komunës së Pejës / Representative of the Municipality of Peja

Fadelete Hoxha - Përfaqësuese e pronarëve të kullave / Representative of the Kulla owners

Nebih Pllana - ProIng, Konsulent për lloari statike / Consultant for static calculations

Misin Misini - ProIng, Konsulent për lloari statike / Consultant for static calculations

2001
RESTAURIMI I KULLËS ODA E JUNIKUT
RESTORATION OF KULLA ODA E JUNIKUT



An EU-funded project
managed by the
European Agency for Reconstruction



DEPARTMENT OF CULTURE




„Restaurimi i 5 kullave në Kosovë 2001-2002“ është një projekt i filluar në fillim të pranverës 2001. Ky është një bashkëpunim mes Agjencionit Evropian për Rindërtim, Fondacionit Suedez Trashëgimia Kulturore pa Kufij(CHwB), Departamentit të Kulturës në Kosovë, Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve në Kosovë dhe Komunitet të Deçanit dhe Pejës. Restaurimi është ekzekutuar sipas Parimeve Ndërkombëtare të Restaurimit, duke përdorur materialet dhe teknikat tradicionale. Në të njëjtën kohë, Kullat përshtaten me standartet e jetesës bashkohore. Kompanitë ndërtimore, mjeshtrat dhe materialet tradicionale janë nga regjioni.

Kulla e Brahim Hoxhës, e cila njihet nga popullata lokale si „Kulla Oda e Junikut“ ndodhet në pjesën e vjetër të Komunës së Junikut. I takon tipit të kullës në regjionin e Dukagjinit me dyshekllëk të drurit në katin e sipërm dhe konsiderohet të ketë vlera domethënëse arkitektonike, kulturore dhe historike. Në vitin 1982 ka hyrë në listën e monumenteve të mbrojtura.

Kulla është e vjetër përafërsisht 250 vjet. Është e famshme se ka qenë një kohë të gjatë rezidencë e gjykatësve të Kanunit të Lekë Dukagjinit, ligji verbal shqiptar prej shek. të 15-të.

Kulla „Oda e Junikut“ është djegur në vitin 1999. Vetëm muret e trasha të gurit kanë shpëtuar prej zjarrit. Objekti ishte gërmadhë por muret nuk ishin shumë të dëmtuara. Pjesët e sipërme të mureve të gurit janë çmontuar dhe ndërtuar përsëri. Në brendësi çdo gjë është ribërë, me rikonstruim të pamjes dhe materialeve sa më shumë që është mundur origjinale në përdhësë dhe në katet e sipërme, derisa kati i dytë është adaptuar sipas standardeve moderne të jetesës.



"Restoration of 5 Kullas in Kosovo 2001-2002" is a project initiated in early spring 2001. It is a cooperation between the European Agency for Reconstruction (EAR), the Swedish Foundation Cultural Heritage without Borders (CHwB), the Department of Culture in Kosovo, the Institute for Protection of Monuments in Kosovo and Municipalities of Deçan/Decani and Peja/Pec. The restoration is executed according to International Restoration Principles, using traditional materials and techniques. At the same time the Kullas are adapted to modern standards. The building companies, the craftsman and the traditional materials are from the region.

The Kulla of Brahim Hoxha, which is known among the local population as "Kulla e Junikut" or "Oda e Junikut", is located in the oldest part of Junik municipality. It belongs to the type of Kulla of the Dukagjin region that has a wooden gallery in the upper floor and it is considered to have significant architectonic, cultural and historical values. It was listed as a protected monument in 1982.

The Kulla is approximately 250 years old. It is famous for having been the residence of the judges of the Kanon Lek Dukagjin, the oral Albanian law from the 15th century.

Kulla "Oda e Junikut" was burned down in 1999. Only the thick walls made by stones survived the flames. The upper parts of the stone wall were dismantled and built up again. In the interior everything was remade, with a reconstruction of the original look and materials as much possible in the ground and the top floors, while the first floor is adapted to modern living standards.



2007 PLANI I KONSERVIMIT DHE I ZHVILLIMIT PËR JUNIKUN JUNIK CONSERVATION AND DEVELOPMENT PLAN

EKIPI PROJEKTUES / PROJECT TEAM

Ruzhdi Shehu - Drejtor i projektit nga Komuna e Junikut - Kryetar ekzekutiv (ekonomist) / Project Director from Junik Municipality - Chief of Executive (economist)

Sali Shoshi - Drejtor i projektit nga CHwB (arkitekt) / Project Director from CHwB (architect)

Enes Toska - Projekt Menaxher nga CHwB (kand. arkitekt)/ Project Manager from CHwB (cand. architect)

PhD. Christine E. Kohlert - planer urban dhe arkitekt / urban planner and architect

Prof. Dr. Fejaz Draqolli - historian i artit / art historian

Idriz Shala - ekspert i GIS-it / GIS expert

Bardha Meka - kand. arkitekt / cand. architect

Edon Mullafetahu - student i arkitekturës / architecture student

Genc Gafurri - kand. arkitekt / cand. architect

Jehona Valla - kand. arkitekt / cand. architect

Valdete Pacolli - kand. arkitekt / cand. architect

Valmira Ajeti - kand. arkitekt / cand. architect

Zana Ramadani - kand. architect / cand. architect

KOORDINATORI PËRGJEGJËS NGA KOMUNA E JUNIKUT / RESPONSIBLE COORDINATOR FROM JUNIK MUNICIPALITY

Xhavit Veliaj - Drejtor i Departamentit të Planifikimit Urban, Gjeodezisë dhe Kadastrit në Komunën e Junikut (Inxhinjer i makinerisë) / Director of Urban Planning, Geodesy and Cadastre Department in Junik Municipality (engineer of machinery)

KËSHILLI I EKSPERTËVE / COUNCIL OF EXPERTS

Xhevat Gorqi - Kryetari i Këshillit, arkitekt / Head of Council, architect

Shkëlzen Shehu - arkitekt / architect

Ferdone Tofaj - arkitekt / architect

Shkelzen Goqi - inxhinjer / engineer

Halit Haxhiu - inxhinjer / engineer

Leonora Kuçi - biologe / biologist

Asllan Gaxherri - gjeograf / geographer

Agim Maka - ekonomist / economist

Agron Kuqi - jurist / jurist

PËR PËRKRAHJE TË PROJEKTIT DO TË FALENDËRONIM / FOR THE SUPPORT WE WOULD LIKE TO THANK

Xhemë Shehu - Zyrtar i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës në Komunën e Junikut / official from Geodesy, Cadastre and Ownership in Junik Municipality

Të gjithë përfaqësuesit tjerë të departamenteve të Komunës së Junikut / All other Junik Municipality Department representatives

Përfaqësuesit e Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal të UN HABITAT-it / UN HABITAT Municipal Spatial Planning Support Programme representatives

Të gjithë banorët e Junikut për përkrahje të projektit dhe mikpritje / All Junik inhabitants for their support and hospitality for the project

* Kandidat arkitekt nënkupton absolvent të arkitekturës / candidate architect refers to last year architecture student

Hyrje - Pilot Njësia Komunale e Junikut në bashkëpunim me CHwB-në

Pilot Njësia Komunale e Junikut në bashkëpunim me CHwB-në ka filluar implementimin e Planit për zhvillimin dhe ruajtjen e Junikut.

Pilot Njësia Komunale (PNjK) e Junikut në bashkëpunim me fondacionin Suedez “Trashëgimia Kulturore pa Kufij”- zyra në Kosovë ka filluar implementimin e projektit të planit për ruajtjen dhe zhvillimin e Junikut.

Më 21 Shkurt 2007 PNjK e Junikut dhe CHwB kanë nënshkruar Marrëveshjen e Mirëkuptimit lidhur me këtë projekt.

Faza e parë e projektit ka ndodhur gjatë muajit Mars, Prill dhe Maj 2007. Grupi punues i projektit i përbërë nga arkitektët e rinjë të angazhuar nga CHwB nën mbikqyrje të PhD. Christine E. Kohlert (planer urban dhe arkitekt) ka punuar në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e Kuvendit Komunal të Junikut.

Ky projekt përbëhet nga analizat urbane gjenerale dhe arkitektonike të Junikut duke marrë në konsiderim të gjitha komponentet për zhvillim urban, fokusohet posaçërisht në objektet me vlera kulturo-historike, në intervistat e banorëve, planifikimin urban, projektet specifike në fushat e ndryshme potenciale, dokumentet fotografike, formimi i udhërëfyesit, etj....

Më 24 Prill 2007 është mbajtur mbledhja e parë publike ku është prezentuar data baza e parë e intervistave me përshtypjen e banorëve për projekt, statistikat teknike të objekteve, idetë dhe vizionet për të ardhmen. Në mbledhje ishin prezent përfaqësuesit e PNjK të Junikut, UN Habitatit, përfaqësuesit e CHwB-së, profesionist të pavarur, etj.

Pas shtatë javë punë të fazës në terren grupi punues ka finalizuar studimin e gati 1300 objekteve. Përpos kësaj janë bërë analizat specifike për objektet historike, elementet e ndryshme arkitektonike, hapësirave publike, qarkullimin e trafikut, etj.

Hapi i ardhshëm i projektit do të jetë organizimi i punëtorisë së Vizionimit për Junikun. Kjo punëtori do të bashkë-organizohet nga UN Habitatit, CHwB dhe Komuna e Junikut. Qëllimi i punëtorisë është vizionimi i zhvillimeve të ardhshme të Junikut. Kjo punëtori gjithashtu do të ofroj mundësinë e diskutimit të çështjes së tanishme të planifikimit të aktiviteteve dhe hapave të ardhshëm që çojnë kah Plani Urban zhvillimor i Junikut.

Projekti është i bashkë-financuar ndërmjet PNjK të Junikut dhe CHwB (SIDA si donatorë kryesor). Raporti final i projektit do të jetë i publikuar në prezantimin publik në Junik gjatë javës së 26-të (java e fundit e Korrikut).

Introduction - Pilot Municipal Unit of Junik in Cooperation with CHwB

Pilot Municipal Unit of Junik in cooperation with CHwB has started implementing Preservation and Development plan of Junik.

Pilot Municipal Unit (PMU) of Junik in cooperation with Swedish foundation “Cultural heritage without borders” - Kosovo office has started the implementation of the project Preservation and Development Plan of Junik.

On February 21st 2007 PMU Junik and CHwB have signed Memorandum of Understanding regarding this project.

The first phase of the project was held during March, April, May 2007. Project Team consisted from a team of young architects engaged from CHwB and supervised by PhD. Christine E. Kohlert (urban planer and architect) that worked in close cooperation with experts from Municipal Assembly of Junik.

This project consisted from urban general and architectural analysis of Junik taking in consideration all components for urban development, focused especially on buildings with cultural-historical values, inhabitant's interviews, urban planning, specific projects on different potential areas, photo documentation, guideline compilation, etc...

On April 24th 2007 first public meeting was held in which were presented the first database of interviews with inhabitant's opinions for the project, the technical statistics of buildings, ideas and visions for the future. In the meeting were present representatives of PMU of Junik, UN Habitat, representatives from CHwB, freelance professionals, etc.

After seven weeks of fieldwork phase Project Team have finalized to survey nearly 1300 buildings. Beside this, specific analyses were done for historic buildings, different architectural elements, public spaces, traffic circulation, etc.

Next step of the project will be organizing a Vision Workshop for Junik. This workshop will be co-organized between UN Habitat, CHwB and Junik municipality. Workshop will aim at visioning the future developments of Junik. This workshop will also offer an opportunity to discuss the issues of current state of the planning activities and future activities leading to the Junik Urban Development Plan.

The projects is co-financed between PMU of Junik and CHwB (Sida as main donor) Final report of the Project will be published in the public presentation that will be held in Junik during the week 26 (last week of June).

Metodologjia e aplikuar për Analizën e Planit zhvillimor

Ky studim fillon me historikun e shkurtër të Junikut, origjinën e emrit të tij dhe lokacionin e komunës, i përcjellur me karakteristika natyrale specifike dhe topografike. Për ta kuptuar më mirë zonën janë udhëhequr intervista me përfaqësues të banorëve. Kjo është përcjellur me hulumtim të plotë të tërë regjionit të planifikuar me ekspertiza sistematike të terrenit, që kanë përfshirë 1,420 stuktura të objekteve të zonës kadastrale të Junikut. Për këtë arsye Juniku është ndarë në shtatë zona kryesore, duke filluar nga qendra e fshatit. Ekipet gjithmonë prej dy personave i punonin anketat dhe gjithashtu bënë fotografi për data bazë. Në disa grupe punuese janë ftuar të merrnin pjesë edhe vendasit e rinjë të shkollave të mesme.

Për kuptim më të mirë të trashëgimisë kulturore dhe mbetjet e strukturave të kullave në Komunë, hulumtimi i mëtejshëm është ndërmarrë duke përfshirë të gjitha kullat dhe gjendjen ekzistuese të tyre. Është bërë lista e të gjitha kullave dhe për secilën është plotësuar fleta hulumtuese lidhur me tiparet dhe karakteristikat e tyre të veçanta. Së bashku me data bazën e fotove ne kemi mundur t'i karakterizojmë ato, për të kuptuar më mirë mundësinë e restaurimit të mëtejshëm dhe funksionin e ri për secilën prej tyre.

E njëjta është bërë edhe për objektet religjioze dhe mullinjtë e asaj zone, si dhe një shembull për llojet e ndryshme të portave tradicionale përgjat rrugëve të Komunës së Junikut.

Hapi i ardhshëm ishte evaluimi i të gjitha të dhënave të tubuara, duke konsideruar qëllimin dhe synimin e cekur në studim. Të dhënat e studimit të terrenit janë futur në programin GIS (Sistemi gjeografik Informativ), i cili na mundëson prodhimin e hartave për të gjitha strukturat me rëndësi dhe shfytëzime. Hartat janë të lidhura ngushtë me shfytëzimin e tokës, shfytëzimin e objekteve, me gjendje të objekteve, numër të kateve, materiale konstruktive, zotërim të objekteve, moshë të objekteve, si dhe aspekte transportuese, demografike, socilae dhe kulturore. Kushtet ekzistuese të tërë planifikimit regjional janë vlerësuar në këtë mënyrë dhe të priturat e ardhshme janë vlerësuar dhe punuar në detale.

Ka pasë edhe shumë vëzhgime të ndërrmarra në zonë, për ta punuar udhërrëfyesin për detale strukturale, si gardhet, muret dhe portat hyrëse, si dhe të gjitha përrojet që rrjedhin nëpër Komunë. Idetë dhe vizionet e para janë zhvilluar për të dhënë këshilla për zhvillim të mëtejshëm për një fshat më të mirë për banorët, si dhe për turistët e ardhshëm dhe për përmirësim të ekonomisë në regjion.

Përfundimisht propozimet për implementim janë punuar, së bashku me planin veprues për zhvillim të zonave të veçanta, si dhe janë dizajnuar udhërrëfyesit për objekte të reja dhe zhvillime.

Applied Methodology for the Development Plan Analysis

This study starts with a brief history of Junik, the origin of its name and the location of the municipality, followed by specific natural and topographic characteristics. To get a better understanding of the area interviews were conducted with a representative average of the inhabitants. This was followed up with a thorough investigation of the whole planning region by a systematic field survey, which included 1,420 building structures of the cadastral zones of Junik. For this reason Junik was divided in seven main zones, starting at the center of the village. Teams of always two persons were operating the surveys and also taking pictures for a database. In some of the teams local youths from the secondary school were invited to participate.

For a better understanding of the cultural heritage and the remaining structures of kullas in the municipality, a further investigation was undertaken to cover all the kullas and the state they are in. All kullas were listed and for each one an investigation sheet was filled about their special features and characteristics. Together with the data base of photographs we were able to categorize them, to get a better understanding of the possibilities for further refurbishment and new functions for each of them.

The same was done for the religious buildings and the mills in the area, as well as a sample number of different kind of traditional gates along the streets of Junik municipality.

Next step was the evaluation of all the data gathered, under consideration of the goals and objectives stated in the study. The data of the field survey were put to a GIS (Geographic Information System) program, which enabled us to produce maps for all important structures and uses. The maps are related to land use, building use, building conditions, number of storeys, construction materials, building occupancy, age of buildings, as well as transportation and demographic, social, and cultural aspects. The existing conditions of the whole planning region were evaluated in this way and future expectations were evaluated and worked out in detail.

There were also a lot of observations undertaken of the area, to work out guidelines for structural details, like fences, walls and gates, as well as all the brooks running through the municipality. First ideas and visions were developed to give advice for further development for a better village for the inhabitants as well as for future tourists to improve the economy of the region.

Finally proposals for implementation were worked out, together with action plans for the development of specific zones, as well as design guidelines for new buildings and developments.

Kulla si banesë shqiptare në Rrafshin e Dukagjinit

Ndërtimtarinë popullore kosovare, përkatësisht shqiptare e pasurojnë edhe objektet e arkitekturës fshatare të banimit të tipeve dhe varianteve të ndryshme që u ndërtuan gjatë periudhës së sundimit osman. Natyrisht që objektet nga periudhat e hershme, përkatësisht nga shekujt XV, XVI e XVII nuk kanë mbetur. Mirëpo duhet theksuar se, padyshim, ndërtimet e mëvonshme të realizuara nga mjeshtër lokal kanë përcjellë skemat kompozicionale të ndërtimeve të mëparme.

Ndërtimet e arkitekturës fshatare ishin nga ato më të thjeshtat, me një ambient, e deri te tipi i çardakut, ndërtime të realizuara deri në shek XIX. Në Rrafshin e Dukagjinit është i njohur edhe një tip i arkitekturës fshatare. Fjala është për ekzemplarët e kullave si objekte të banimit ekzistenciale shqiptare.

Kulla si banesë ekzistenciale shqiptare në Rrafshin e Dukagjinit paraqitet si një produkt dhe proces i një zhvillimi të gjatë historik, nga e cila lindi dhe u zhvillua në mënyrë evolutive ky ndërtim me tipare të veçanta kompozicionale, konstruktive, funksionale, teknike, trajtësore e që në vetvete përmbanë elemente të caktuara dhe specifike shqiptare. Disa nga këto kulla veçohen me vlerat e tyre artistike e estetike si nga trajtimi i anës së jashtme, po ashtu edhe nga ai i anës së brendshme. Pikërisht për këtë, kjo kullë, një arkitekturë origjinale shqiptare, bën që të veçohet dhe të dallohet si për skemën kompozicionale, ashtu edhe për pasurinë e elementeve të saj, forma e këtij ndërtimi nga realizimet e tipit të njëjtë jashtë territorit etnik shqiptar në zonën e Gadishullit Ballkanik dhe më gjerë. Kulla është banesë karakteristike e arkitekturës popullore, e cila me kohë u bë mbizotëruese në disa treva shqiptare e Rrafshin e Dukagjinit dhe në Drenicë në veçanti.

Është me interes të posaçëm të theksohet se ky ndërtim u përhap në të gjitha shtresat popullore, sidomos fshatare, përveç ndër feudalët dhe të pasurit. Numri i madh kullave që kanë mbetur deri në ditët tona, është tregues i përhapjes së madhe që pati ky lloj ndërtimi si banesë ekzistenciale fortifikuese në shtresat e popullsisë fshatare e qytetare shqiptare.

Në mbështetje të asaj që u parashtrua, mund të arrijmë lirisht në përfundimin se kulla si banesë e fortifikuar është i vetmi tip arkitekturor banesë te shqiptarët që përfaqësohet në treva të caktuara në të gjitha shtresat popullore dhe pikërisht për këtë ne mund ta quajmë pa ngurrim edhe kullën si banesë e të gjitha shtresave shqiptare.

Kulla si banesë a fortesë familjare ekzistenciale me bazë kënddrejtë, dy, tri e rrallë herë katër katësh (sipas njësimi në popull) kishte edhe funksione të caktuara. Në përdhësë ishte ahuri për strehimin e kafshëve, në kat “shtëpia e zjarrit” dhe qilarët që shfrytëzohen nga anëtarët e familjes, kurse në atë më të lartë “Oda e burrave” ose e mysafirëve. Kjo kullë, pos funksionit të banimit dhe të mbrojtjes në rast nevojë, kishte edhe dedikime të tjera. Oda e burrave luajti rolin e një institucioni me rëndësi të veçantë historike, shoqërore, politike ekonomike, kulture, juridike, arsimore etj. gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare, por edhe më pas, në varrësi të rrethanave dhe kushteve shoqërore-politike në Kosovë.

Complexes of Old Village Kullas

Kosovar and Albanian vernacular creations are particularly enriched by architectural buildings in villages of different types and variants, built during the Ottoman rule. Naturally, buildings from the 15th, 16th and 17th centuries did not survive to today. However, one must note that buildings constructed later by local craftsmen have followed the compositional schemes of previous buildings.

Architecture of the village buildings ranged from the simplest type, with one room, to the most elaborate types with garrets – enclosed balcony (çardak), which were built until the 19th century. However, Dukagjin Plain is famous for another type of village architecture: the kullas, which are known as Albanian existential dwellings.

Kulla as an Albanian existential dwelling in Dukagjin Plain appears as a product and process of a lengthy historical development, from which this type of building emerged and evolved with specific compositional, constructive, functional and form features, containing specific and characteristic Albanian elements. Some of these kullas stand out from the others thanks to their artistic and aesthetic values found in their interior and exterior. Due to this, these items of original Albanian architecture are unique in the compositional scheme, as well as richness of their elements, and can only be found inside the Albanian ethnic territory in the Balkan Peninsula and wider. Kulla is a characteristic dwelling of vernacular architecture, which in time became dominating in some parts of the Dukagjin Plain and Drenica, in particular.

One should stress that this type of building spread amid all layers of society, especially among the village people, but it also included feudal and wealthy people. The large number of kullas that have survived until today, are a good indicator of extent of their presence as existential and fortifying type of dwelling found equally among the Albanian village and city population.

Based on this, one can easily conclude that kulla, as a fortified dwelling, is the only architectural type of dwelling among Albanians that is represented in certain regions in all layers of society. Thus, kulla can be considered, without a reserve, to be the ultimate dwelling of all layers of Albanian people.

Kulla as a fortified family house with a rectangular plan and in two or three, rarely four – floors has specific functions. The ground floor served as stable for sheltering house animals, the first floor – house of fire (shtëpia e zjarrit) – and cellars were used by family members, while the top floor – the room of men (oda e burrave) was used for welcoming the guests. This type of kulla, besides its residential and defence functions, also had other uses. The room of men played the role of an institution with great historical, social, political, economical, cultural, judicial and educational importance, during the Albanian National Renaissance and later.



Komplekset e kullave të vjetra fshatare

Kullën si banesë shqiptare, përveç që prezantohet e vetmuar ose e veçuar, mund ta gjejmë edhe grumbull, duke formuar komplekse fshatarake-rurale, ansamble të vjetra të këtij tipi, ndërtime në shumë fshatra të rrafshit të Dukagjinit. Këto komplekse ishin karakteristikë për fundin e shek. XVIII e XIX në përgjithësi.

Komplekse të vjetra të kullave rurale me ekzemplarë të vlerave artistike të tyre, përkatësisht fshatra me kulla që i takonin muzeumeve nën qiellin e hapur, ishin ekzistuese deri në vitin 1998 e 1999, pra para luftës shqiptaro-serbe. Komplekse të tilla kishim në Nivokaz, Botushë, Brovinë, Junik, Carrabreg, Drenoc, Prilep, Deçan, Strellc, Vranoc, Raushiq, Istog, Vrrëllë e në shumë fshatra të tjera të Kosovës.

Duhet theksuar se këto komplekse rurale-arkitekturale janë realizime të krijuara dhe të vendosura kryesisht në terrene të rrafshita. Një karakteristikë e këtyre është se janë të ndara dhe të formuara sipas mëhallëve të familjeve të caktuara. Mëhallët në këto raste paraqesin një element organizues të një pjese të kompleksit fshatarako-arkitektural të banuar. Po ashtu duhet theksuar, njëkohësisht dhe dihet, se mëhalla mund të quhet sipas ndonjë elementi gjeografo-topografik, ndonjë objekti ose familjeje, personi të caktuar. Në rastin e komplekseve të cekura si dhe fshatrave të tjera të Kosovës, mëhallët mbajnë mbiemrat e familjeve të caktuara që jetonin në ato pjesë të komplekseve të kullave

Për të pasur më të kuptueshëm lindjen dhe zhvillimin e komplekseve të kullave të vjetra, do të ndalemi në shembullin e kompleksit të vjetër të Junikut.



Complexes of Old Village Kullas

Kulla as an Albanian dwelling, besides appearing as a standalone or separated, can often be found in groups, thus creating old rural complexes – ensembles in many of the villages of Dukagjin Plain. These ensembles were characteristic for the end of 18th century and the whole 19th century.

Old complexes of rural kullas with artistically valuable examples, i.e. villages with kullas that belonged to open space museums, existing until years 1998 and 1999, that is before the Albanian-Serbian war. Such complexes were located in Nivokaz, Botushë, Brovinë, Junik, Carrabreg, Drenoc, Prilep, Deçan, Strellc, Vranoc, Raushiq, Istog, Vrrëllë and many other villages of Kosovo.

It has to be emphasized that these rural-architectural complexes are mainly built on flat terrain. One of their main characteristics is that they are divided and created based on neighbourhoods of different families. In this case, the neighbourhoods appear as organizing elements of these rural and architectural residential complexes. These neighbourhoods were named based on some geographical or topographical element, a building or a family, or a specific person. In kulla ensembles in the above mentioned villages, as well as in other villages throughout Kosovo, neighbourhoods bear names of different families that lived in those kullas.

In order to have a clear understanding of the “birth” and development of ensembles of old kullas, we shall illustrate the example of the old ensemble in Junik.



Kompleksi i kullave si banesa në Junik

Në territorin e Kosovës ka mjaft fshatra të cilat cilësohen me karakteristikat e tyre gjatë shek. XVIII e XIX. Një ndër këto është edhe Juniku i rrethit të Deçanit. Juniku në periudhën e cekur ishte fshati më i madh i Rrafshit të Dukagjinit dhe në përgjithësi i Kosovës. Të cekim se në mesjetën e vonë Juniku ishte qendër e zhvilluar administrative e tërë Rekës së Kreqe. Në kohën në fjalë, në shekullin XIV edhe Gjakova i takonte nahijës së Alltun-ihlisë, me qendër në Junik. Po ashtu, duhet përmendur se Juniku ishte i banuar edhe në periudhat më të hershme, çka e dokumentojnë të gjeturat e kulturës dhe të trashëgimisë materiale të hasura gjatë rinjohjes së terrenit (këto ishin vrojtime të karakterit kërkimor-shkencor) si dhe të dhënat historike.

Juniku si fshat përbëhet prej shumë lagjeve ose mëhallëve. Mëhalla kryesore, përkatësisht qendrore janë: Tregovishtë, Gacaferr, Berishë. Në mëhallët në fjalë u ndërtuan edhe kullat si banesa të fortifikuara familjare, objekte ekzistenciale të tipit kullë. Pra, në këto mëhalla filloi të zërë fill dhe lindi bërthama e kompleksit të kullave të vjetra të Junikut. Të cekim se kullat më të vjetra janë të mëhallës Tregovishtë. Këtu kemi ekzemplarë të kullave që kronologjikisht janë më të vjetrat e tipit në fjalë. Këtu na prezantohet kulla me murin e drurit të dyshekllekut që del nga muri, muret perimetrale të objektit. Këso dalje të galerisë së drurit në formë ancaku, në katin më të lartë kemi përherë dhe në çdo kullë, jo vetëm në Junik, por edhe më gjerë, në çdo fshat Dukagjinas ku na paraqitet ky ndërtim i variantit të kullës së cekur. Këtij varianti i takon edhe kulla e Avdyl Hoxhës apo siç njihet në popull “Oda e Junikut.” Kulla u ndërtua në mëhallën e Tregovishtës.

Tregovishta me kullat e familjes së Hoxhajve paraqesin bërthamën e kompleksit të kullave të vjetra të Junikut. Njëkohësisht duhet cekur se ky ansambël i kullave filloi të realizohet në dekadat e fundit të shek. XVIII dhe mbaroi në fund të shekullit XIX. Në këtë periudhë mbi njëshekullore u krijua ky vendbanim me këto ndërtime të karakterit të banimit të fortifikuar. Megjithatë, këtu është me interes të ceket dhe të konstatohet se në fshatin Junik u jetua edhe më parë, para kompleksit në fjalë, por me ndërtime të një arkitekture fshatare të tipeve të tjera, të përmendura në këtë studim. Objektet arkitekturale të dedikimit të periudhave më të hershme, pra të kësaj ekzistuese fortifikuese familjare, fatkeqësisht, deri më ditët tona nuk kanë mbetur asnjë ekzemplar. Materiali i dobët, koha, kushtet në rrethana të reja historike, sociale e familjare si dhe faktori njeri e bënë të vetën, ato u shkatërruan dhe në vend të tyre u ndërtuan kullat si banesa a fortesa familjare.

Kullat në kompleksin e vjetër të Junikut ishin të ndërtuara përqëndruara në bazë të familjeve me prejardhje të përbashkët fisnore. Mëhallët ishin të ndara mes vete, meqë fiset preferonin një distancë të tillë. Për këtë të cekur kullat e mëhallëve me një vëllëzëri ishin afër njëra-tjetrës, ndërsa në anën tjetër, të distancuara nga mëhallët me përkatësi jo fisnore. Pra, me këtë bënë të kuptohet se Juniku si vendbanim rural ishte i tipit të mëhallëve, të vëllëzërive.

Ensembles of Dwelling Kullas in Junik

In the territory of Kosovo there are many villages that are distinguished by their characteristics during the 18th and 19th centuries. One of these villages is Junik, near Decan. In this period, Junik was the largest village in the territory of Dukagjin Plain and in all of Kosovo. In late medieval times, Junik was a prosperous administrative center of Reka e Keqe. In this period, in the 14th century, the town of Gjakova used to belong to nahije (ottoman administrative unit) of Alltun-ihli, seated in Junik. In addition, Junik was inhabited since early historic times, which is documented by different cultural and material heritage finds, excavated during terrain recognition (these were studies of research and scientific character), as well as historic data.

Junik, as a village, is consisted of many neighbourhoods. The main or the central neighbourhoods are: Tregovishtë, Gacaferr, Berishë. It is in these very same neighbourhoods that kullas as fortified family dwellings were built. These neighbourhoods were the core of the ensemble of old kullas in Junik. The oldest kullas are in Tregovishtë neighbourhood. Here one can find examples of kullas that are oldest in chronological aspect of development of this type of kullas. Here one can also find the kulla with wooden wall of dyshekllek (topfloor gallery) that emerges from the perimeter walls of the building. The wooden gallery construction in form of a console in the highest floor appears in almost every kulla, not only in Junik, but also in other villages of Dukagjin Plain. The kulla of Avdyl Hoxha or the “Oda e Junikut” Kulla belongs to this exact type of kullas. It was built in Tregovishta neighbourhood.

Tregovishta with kullas of Hoxha family represents the core of the ensemble of old kullas in Junik. It must also be noted that construction of this ensemble started in the last decades of 18th century and was completed at the end of 19th century. However, it is important to emphasize that Junik village was inhabited previously, before the above-mentioned ensemble was built, with buildings of other village architecture types, mentioned in this study. Unfortunately, examples of architectural buildings of earlier periods have not survived to today. Weak materials, time, new historical, social and family conditions and circumstances, as well as the human factor, had a great impact on these early buildings. Consequently they were torn down, and cleared the way for construction of kullas as family dwellings and fortifications.

The kullas in the old ensemble in Junik were built and concentrated around families that had a common clan origin. Neighbourhoods were created far from each other, mainly because clans preferred maintaining such distances. Considering this, kullas of brothers in one neighbour were built close to each other, while the neighbourhoods themselves were organized in such a manner as to indicate clan belonging. This leads to the conclusion that Junik as a rural settlement belonged to the type of neighbourhoods, brotherhoods.

Lagja Tregovishtë, në dallim nga të tjerat, ishte më e dendur dhe për këtë e bënë që ajo të dallohet në këtë aspekt nga lagjet periferike të Junikut. Karakteristikë dhe veçori përfaqësojnë identike kishte edhe mëhalla Gacaferr dhe Berishë.

E veçanta e Junikut ishte se pos mëhallave të përmendura, ndërtimet e tipit kullë filluan të zgjerohen edhe në periferi të vendbanimit. Nga zgjerimi dhe ndërtimi i kullave u krijuan pjesë të komplekseve të reja, konkretisht lindën këto mëhalla: Në lindje mëhalla Çok, Gaxher e Miroc, në perëndim Çestë e Goç, në veri Bajraktar e Pepsh. Ndërtimi i kullave në lagjet periferike nuk ishte aq i dendur si në tri lagjet qendrore të kompleksit arkitektural. Tri mëhallët qendrore krijuan bërthamën e vjetër të Junikut.



Tregovishta Neighbourhood, unlike the others, is denser and this feature clearly distinguishes it from other neighbourhoods in the outskirts of Junik. Almost identical characteristics and features are found in Gacaferr and Berisha Neighbourhoods.

A particularity of Junik is that besides in the above mentioned neighbourhoods, kullas were built also in the village outskirts. This led to creation of new ensembles, respectively new neighbourhoods such are: in the east Çok, Gaxher and Miroc Neighbourhoods, in the west Çestë and Goç Neighbourhoods, in the north Bajraktar and Pepsh neighbourhoods. Kullas in the village outskirts were not as dense as the ones in the three central neighbourhoods of the architectural ensemble. The three central neighbourhoods created the old core of Junik.

Kompleksi i kullave si banesa në Junik

Kullat në kompleksin e vjetër, pos të tjerash i plotësuan nevojat e jetesës dhe në rast nevojë edhe të mbrojtjes familjare e kombëtare. Në një periudhë mbi njëshekullore të ndërtimit të objekteve të fortifikuara, pos kullës me mur druri të dyshekllekut, u realizuan edhe variante të tjera të kullave: kulla me mur guri të dyshekllekut që del nga muri, muret perimetrale si dhe kulla me mur guri të dyshekllekut që nuk del nga muri, muret perimetrale si dhe variantet e tyre. Në Junik kishte edhe kulla me shtrirje horizontale të veçuara ose të shtuara si aneks të kullave tri katëshe.

Meqë jemi në Junik mendojmë të ndalemi edhe në “Odën e Junikut.” Kulla e Hoxhajve, pos vlerës konstruktive-arkitekturale, funksionale, artistike e estetike pati edhe një rëndësi të posaçme. Oda e Junikut ishte institucion juridik, shoqëror e politik. Këtu u mbajtën tubime të ndryshme me rëndësi jo vetëm për Junikun, Rekën e Keqe, por edhe për tërë Kosovën. Në Odë u morrën shumë vendime me interes shoqërorë, politik e juridik, aty u pleqërua, u dënua, u pajtuan gjaqet, u zgjidhën ngatërresa të ndryshme të junikasve dhe më gjerë. Oda kishte 12 odabash nga të gjitha mëhallët e Junikut. Me odabash kryesonte kryeplaku i Odës. Kryeplaku është zgjedhur nga 12 odabashët dhe kryesisht ky post i takonte plakut të Hoxhajve. Pra, kjo ishte pos të tjerash edhe një nga karakteristikat që e bënë kullën në fjalë edhe më të vlefshëm dhe me rëndësi për historinë dhe kulturën shqiptare. Nga kjo mund të kuptohet se si lindën dhe u zhvilluan komplekset e kullave të vjetra në disa fshatra kosovare si dhe rëndësinë e tyre për vetë familjarët, fshatin, rrethin dhe kulturën shqiptare në veçanti.



Ensembles of Dwelling Kullas in Junik

Kullas in the old complex fulfilled the living needs and, if needed, those of family and national protection. In over one century of building fortified dwellings, besides kullas with wooden gallery (dyshekllek) wall, a whole array of other variants of kullas were constructed. Some of these were: Kulla with stone gallery-wall that is set off from the main perimeter walls, the kulla with stone gallery-wall that does not set off from the main perimeter walls, as well as their variants. Junik featured also horizontally-stretched kullas or those that were added as an annex to three-story kullas.

Since Junik is our case study, we should elaborate further on the “Oda e Junikut” Kulla. The kulla of Hoxha family, besides its constructive, architectural, functional, artistic and aesthetic values, was also of great importance. “Oda e Junikut” was a judicial, social and political institution. It was the venue of different gatherings of great importance not only for Junik, Reka e Keqe, but for the whole of Kosovo. Many decisions were taken in this kulla regarding social, political and judicial matters; in it, many issues were discussed and judged, blood feuds and quarrels of Junik inhabitants and others were settled. The “Oda” had 12 odabash from all neighbourhoods of Junik. Odabashes were chaired by the Head of Oda. The Head of Oda was elected from the 12 odabashes and this position mainly belonged to the eldest man in Hoxha family. This is one of the characteristics that make this kulla even more valuable and important for the Albanian culture and history. This conveys the idea of how old kulla ensembles were born and developed in some of the Kosovar villages, as well as their importance for the family members, the village, the surroundings and the Albanian culture.



Gjendja e aglomeracionit rural e kullave në Junik

Në ditët e sotme nuk mund të flasim për një kompleks, aglomeracion rural të kullave në Junik. Faktori kohë, kushtet atmosferike si dhe faktori njeri e posaçërisht forcat paramilitare e policore serbe ishin shkaktar kryesor në djegien dhe rrënimin e kullës si banesë ekzistencionale në Junik gjatë viteve të luftës 1998/99 në veçanti. Qëllimi i këtyre forcave ishte zhbërja e kulturës materiale, të trashëgimisë shqiptare. Por duhet theksuar se kjo trashëgimi filloi të shkatërrohet edhe nga pronarët e kullave. Një numër i madh i kullave që adaptuar dhe u qenë përshtatur nevojave të jetës bashkëkohore. Në këtë mënyrë dhe formë të adaptimit disa nga ekzemplarët arkitekturorë të tipit kullë kanë humbur në masë të madhe e në disa raste tërë trajtat dhe elementet karakteristike ndërtimi-arkitekturorë nga gjendja origjinale, por për të qenë edhe më keq për kulturën materiale dhe arkitekturale shqiptare, një numër jo i vogël i kullave qenë të rrënura dhe kështu kishin humbur gjurmët në tërësi.

Në një veprim të tillë posaçërisht pas Luftës së Dytë Botërore ndikoi, përveç kushteve materiale të pronarëve, edhe mos interesimi i shoqërisë, institucioneve kosovare a mosnjohja e vlerave të larta, si dhe e rëndësisë së këtyre objekteve që kanë për kulturën materiale dhe për historinë e shqiptarëve. Në këtë mënyrë pronarët e kullave, junikasit, por jo vetëm ata shkëpusin, duke mos qenë të vetëdijshëm, pjesët më jetike dhe më origjinale të trashëgimisë shqiptare dhe të vlerave arkitekturorë në Junik dhe më gjërë.

Në kuadër të kompleksve të kullave të mëhallave të familjeve junikase u ndërtuan mjaft shtëpi të banimit të cilat nuk i përgjigjen as stilit e as strukturës së muratimit të objekteve të vjetra. Pra, këto ndërtime me një material të ri (tulla të kuqe, beton e hekur) jo vetëm që degraduan mjedisin ekzistues të aglomeracionit rural të kullave, por ndikuan në zbehjen e arkitekturës tradicionale të realizuar nga mjeshtër me përvojë.

Adaptimet, shkatërrimet individuale nuk ishin pothuaj asgjë për dallim nga këto të viteve të cekura të luftës shqiptaro-serbe. Me këtë rast, në këtë rrëmujë u djegën dhe u rrënuan deri në themele ekzemplarët më tipik të kullave të arkitekturës, të aglomeracionit të kompleksit rural të Junikut. Këto rrënime ishin të planifikuara dhe të koordinuara nga forcat policore e paramilitare serbe. Sot, pos kullës “Odës së Junikut” (kjo kullë u restaurua në menaxhim të CHwB) dhe një tjetër poashtu të kësaj mëhallëje, pra të Tregovishtës, dy kulla të mëhallës së Pepshëve, mullirit të mëhallës së Gacaferëve dhe të Berishëve, po thua nuk ka ngelur asnjë ndërtim tjetër tradicional në gjendje të cilën do ta dëshironin realizuesit dhe pronarët e tyre të kohës.

Të theksojmë se në Junik kemi mjaft rrënoja të kullave. Nga ato kanë ngelur muret, në ndonjërin vetëm një mur konstruktiv. Mirëpo, kemi edhe gur të grumbulluar pa kurrfarë trajte të mureve të kullave. Këto kulla përkujtojnë gjendjen e pas luftës, të qershorit të vitit 1999. Duhet cekur se aty këtu kemi mure avllie apo të oborrit të ngelur nga koha apo edhe rishtas të murosur në mënyrë tradicionale. Ndërkaq në brendësinë e oborrit është ngritur shtëpi banimi bashkëkohore dy dhe tre katëshe.

Në qendër të Junikut kemi edhe një xhami të adaptuar, përkatësisht të rindërtuar në themele të objektit të vjetër që më parë kishte strukturën dhe elemente të ndërtimit të traditës. Një adaptim (pas djegies dhe rrënitimit nga lufta) përjetoi edhe Xhamia e Çokut e ndërtuar në shek. XVI. Pra në vija të trasha paraqitëm gjendjen e kompleksit të kullave të vjetëra në mëhalla të familjeve të vjetra junikase.

State of Rural Agglomeration of Kullas in Junik

Nowadays, we could hardly speak about an ensemble or rural agglomeration of kullas in Junik. Time, weather and human factors, and particularly the Serb police and paramilitary forces, were the main reasons for burning down and destruction of kullas as an existential dwelling in Junik during the war period in 1998 and 1999. The aim of these forces was to undo the material culture of Albanian heritage. However, it must be stressed that this heritage started to be destroyed by the owners of kullas themselves. A large number of kullas was adapted to the needs of modern life. By doing so, many of the architectural examples of kulla types have been lost. In some cases, only characteristic constructive and architectural elements and features suffered, but in other cases, many kullas were totally destroyed, thus causing a great loss for the Albanian material and architectural culture.

This phenomenon, which occurred mainly after the Second World War, was largely influenced by financial situation of the owners as well as lack of interest for kullas from the society and Kosovo institutions, and failure to recognize the high values and importance of these buildings for the material culture and history of Albanians. In this way, Junik inhabitants and others, unconsciously, took apart the most vital and original parts of the Albanian heritage and architectural values in Junik.

Within the kulla ensembles in family neighbourhoods in Junik, many houses that did not correspond with style and construction structure of the old buildings were built. These buildings, constructed of new materials (red bricks, concrete and iron), not only degraded the existing ambience of the rural agglomeration of kullas, but also led to overshadowing of the traditional architecture, realized by experienced craftsmen.

Adaptations and individual destruction were minor compared to the effects of the Albanian-Serbian war. During this period, the most typical architectural examples of kullas from the rural agglomeration of Junik were burnt down and destroyed. These destructions were planned and coordinated by Serb police and paramilitary forces. Nowadays, except the “Oda e Junikut” kulla (which was restored under CHwB's management) and another kulla in the same neighbourhood of Tregovishta, two other kullas in Pepsh neighbourhood, the mill of the Gacafer and Berisha Neighbourhoods, almost all other traditional buildings are not in good state.

It must be stressed that Junik experienced the destruction of many kullas. The only parts remaining from them are the outer walls. Often, shapeless piles of stones are the only thing remaining from kullas. These kullas are a reminder of the situation after the war, in June 1999. It must be noted that in these cases we often deal with yard walls from older periods or newly constructed in traditional way. Meanwhile, in the inner part of the yard, two or three-story high modern houses have been built.

In the centre of Junik there is an adapted, respectively a rebuilt mosque on top of the foundations of an older building, that had the structure and the elements of traditional buildings. The Çok Mosque, built in the 16th century, was adapted after it was burnt and destroyed during the war. This has been a rough outline of the situation of ensembles of old kullas in neighbourhoods of Junik families.

Mjedisimi i kullave në planin urbanistik të Junikut

Juniku gjendet në pjesën veri-perëndimore të luginës së pasur të Rrafshit të Dukagjinit, para grykës piktoreske të lumit Erenik, i cili kalon përmes Alpeve Shqiptare. Ai kufizohet nga komuna e Deçanit dhe komuna e Gjakovës si dhe nga Shqipëria në anën veriore. Juniku është i përbërë prej fshatrave të zonës kadastrale Voksh, Sllup, Jasiq, Gjocaj dhe Rastavicë. Ai shtrihet në një sipërfaqe prej 86,2 km². Ai ka një pozitë të favorshme gjeografike, me një mesatare prej 367-500 metra mbi nivelin e detit, e cila bën të mundur në këtë komunë zhvillimin e turizmit të malit dhe të fshatit.

Njëherit duhet theksuar se gjatë planifikimit hapësinor e urbanistik duhet dhënë rëndësi dhe kujdes të posaçëm veprave të arkitekturës tradicionale si atyre të banimit, kullave, po ashtu edhe disa objekteve të karakterit publik, pra të mullinjëve të ngelur të cilët ruajnë gjendjen fillestare, origjinale të tyre nga koha e ndërtimit, shek. XIX. Kullat ekzistuese si komplekse apo edhe të veçuara si dhe mullinjët duhen të integrohen dhe mjedisohen në planin urbanistik të Junikut. Duhet të shihet mundësia që edhe disa kulla ekzistuese të restaurohen. Po ashtu nuk duhet lënë anash edhe disa rrënoja të kullave ku e tëra që ka mbetur janë muret konstruktive ekzistuese. Këto kulla ose të restaurohen apo të konservohen në gjendjen e tanishme. Është e udhës të gjendet mundësia për konservimin e ndonjë kulle me qëllim që t'u tregohet gjeneratave të ardhme siq ndodhi dhe si nuk duhet vepruar ndaj një trashëgimie.

Urbanistët dhe planerët duhet të jenë vigjilent që gjatë përpilimit të planit hapësinor dhe urbanistik të Junikut të ruajnë thesarin ekzistues kulturor (disa janë të shpallura në mbrojtje të ligjit si monumente kulturo-historike) pa marr parasysh gjendjen e tyre.

Kjo trashëgimi, lokalitet arkeologjik, rrënojë e objekteve arkitektonike apo edhe ndërtime në tërësi ekzistuese duhet që në të ardhmen të aktivizohen si në aspektin etnomuzeologjik, përkatësisht të muzeut nën qiellin e hapur, të integritetit në planifikimin hapësinor me qëllim të shfrytëzimit të tyre në zhvillimin ekonomik, turistik dhe prezentativ të thesarit, trashëgimisë kulturore të Junikut.

Njëherit ky është qëllimi i këtij studimi që ta ruajmë, të mbrojmë, të konservojmë, të restaurojmë, të prezantojmë, të regjenerojmë, të revitalizojmë duke përfshirë dhe dhënë dedikime dhe funksione të caktuara çdo objekti, por pa e degraduar dhe cenuar tërësinë dhe integritetin e monumentit.



Incorporation of Kullas in the Urban Plan of Junik

Junik is located in the north-western side of the rich Dukagjin Plain valley, in front of the picturesque gorge of Erenik River, which runs through the Albanian Alps. It borders Deçan and Gjakova municipalities, as well as Albania on the northern side. Junik is consisted of villages of cadastral zone Voksh, Sllup, Jasiq, Gjocaj and Rastavice. It covers an area of 86,2 km². It has a favourable geographical position, with an average of 367-500 meters above the sea level, which gives this municipality the possibility of development the mountain and village tourism.

It must be noted that spatial and urban planning should pay particular attention to works of traditional architecture, such are those of residential character – kullas, as well as buildings of public character – mills that are still preserved in their original state, since the time when they were built in the 19th century. The existing kullas that are either parts of an ensemble or are standing alone, as well as the mills, must be integrated and fit into the environment in the urban plan of Junik. In addition, the possibility of restoring some of the existing kullas should be looked at. Also, remaining bearing walls of some of the destroyed kullas should not be left aside, as they should either be restored or conserved in their current state. It would be highly recommended to conserve one of these kullas in order to show to future generations what happened and how not to treat heritage.

Urban planners should be vigilant during the drafting of the spatial and urban planning of Junik in order to preserve the existing cultural treasure of Junik (some of these items have been protected y law as cultural and historical monuments), regardless its state.

This heritage, be it an archaeological site, remains of architectural buildings or existing buildings, should be put in use in the future as ethnological open space museums. They should be integrated in spatial planning with the aim of using them for economic and tourist development and representation of the treasure of cultural heritage of Junik.

This presents, at the same time, the aim of this study: to preserve, protect, conserve, restore, present, regenerate and revitalize by assigning new uses and functions to every building, but without degrading or endangering the integrity of the monument.



Kullat – Hyrje

Konstruksioni arkitektonik i kullave shqiptare si rezidencë banimi ka pësuar prej shumë faktorëve në shek. XVIII dhe XIX deri në vitin 1912.

Këta faktorë mund të ndahen në dy grupe: Faktorët fiziko-gjeografik dhe faktorët socio-ekonomik. Duhet të ceket që në mesin e këtyre faktorëve, janë të një rëndësie tejet të madhe edhe përbërja gjeologjike e tokës, klima, llojet e ndryshme të bujqësisë, struktura familjare, historia dhe sistemi socio-politik etj.

Në mesin e gjërave tjera, fondi i mjeshtërve Dibran, ishte inspirim për banesat e fortifikuara të shqiptarëve të cilat janë transformuar gjatë periudhave të ndryshme historike. Disa elemente sikur plani katrorë, teknika konstruktive, vrimat e armëve si elemente mbrojtëse, kulmet me fiksime, etj., janë gërshetuar së bashku dhe janë aplikuar në rezidencat e tipit të kullave në shek. XVIII dhe posaçërisht gjatë shek. XIX.

Prandaj, në kulla si rezidencë shqiptare ne mund të gjejmë elemente arkitektonike konstruktive të sistemeve të ndërtimeve të fortifikuara lliro-Shqiptare. Kulla si rezidencë shqiptare është prezentuar si element dhe proces i zhvillimit historik. Karakteristikat specifike kompozicionale, funksionale dhe konstruktive poashtu përmbajnë elemente specifike shqiptare.

Kullat - Informatë gjenerale

Arkitektura e kullave si rezidencë shqiptare duhet të kuptohet që është arkitekturë me gur si material konstruktiv, për t'ia dhënë rezidencës karakterisistikën e kalasë. Më saktësisht kulla është konstruksion i fortifikuar i materialit të gurit i stilit të shqiptarëve neoklasik me destinim primar të banimit.

Kulla është rezidencë ose fortesë e ekzistimit familjarë me bazë drejtëkëndëshe, me dy apo tri kate dhe shumë rrallë me katër kate. Bazamenti zakonisht përdorej për mbrojtje të kafshëve, në katin e parë është “dhoma e zjarrit” dhe dhomat për deponim të shfrytëzuara nga anëtarët e familjes dhe kati i sipërm është dhoma ku mblidhen burrat (oda e burrave).

Kulla përpos funksionit të banimit dhe mbrojtjes në raste emergjente kishte edhe kuptime tjera. Oda e burrave ka luajtur rolin e institucionit me rëndësi të madhe historike, sociale, politike, ekonomike, kulturore, juridike dhe edukative gjatë rilindjes kombëtare të shqiptarëve si dhe më vonë varrësisht nga kushtet socio-politike në Kosovë.

Ndriçimi dhe ajrosja e kullave është bërë përmes hapjeve, dyerve, dritareve, dritareve të vogla në formë të vrimave etj.. Dyert dhe dritaret janë të mbuluara me harqe prej së jashtmi por ka edhe lloje tjera të mbuluara me okulus. Në përdhësë dritaret janë të vogla dhe në formë të vrimave. Dyert janë të siguruara me shul. Në katin e parë dritaret janë më të mëdha dhe depot i kanë hapjet e veta. Dhoma e mysafirëve ka dy e në disa raste edhe tri dritare.

Kullas – Introduction

Architectural construction of kullas as an Albanian existential residence was affected by many factors in the XVIII century, and the XIX century until 1912.

These factors can be divided in two groups: Physical-geographical factors and social-economic factors. It should be pointed out that in these groups of factors, among others, the geological content of the field, climate, different kinds of agriculture, family structure, history and the social-political system and so on are of great importance.

Dibran masters found, among other things, inspiration in Albanian fortified dwellings which were transformed during different historical periods. Some of the elements, as square plan, construction technique, slits for guns as protection elements, hipped roofs, etc., were mixed together and applied on residences of the kulla type in the XVIII and especially during the XIX century.

Therefore, in the kulla as an Albanian residence, we can find architectural construction elements of fortified Illyrian-Albanian building systems. The kulla as an Albanian residence is presented as a product and a process of a long historical development. The specific compositional, functional and constructive characteristics also contain specific Albanian elements.

Kullas - General Information

The architecture of a kulla as an Albanian residence should be understood as an architecture done with stone as construction material, so to give the residence the characteristic of a fortress. More precisely, a kulla is a fortified architectural construction of the Albanian neoclassic style with its priority purpose of dwelling.

A kulla is a residence or existential family fortress with a rectangular base; it usually has two or three floors and very rarely four floors. The basement was usually used for animal sheltering, on the first floor is “the fire house” and storage rooms that were used by family members and on the upper floor is the men's gathering room (oda e burrave).

The kulla, apart from its dwelling function and protection in case of emergency, had also other meanings. The men's gathering room played the role of an institution with great historical, social, political, economical, cultural, juridical and educational importance during the Albanian national renaissance and even later depending on the social-political circumstances in Kosova.

Lighting and air conditioning of a kulla is done through openings, doors, windows, small windows in form of the slits etc. Doors and windows are covered with an arch outside but there are also other types that are covered with an oculus. On the ground floor windows are small and in the form of slits. The door there is secured by a bolt. On the first floor windows are a bit bigger and storages have their own openings. The guest room is lit with two and in some cases even with three or four windows.

Gjatë 250 vjetëve të periudhës konstruktive, kullat janë prezentuar në katër varianta dhe pesëmbëdhjetë nën varianta.

Ky përcaktim dhe ndarje bazohet në: tipin e ballkonit (dyshekllekut) të kullës dhe sipas pozitës së shkallëve


Juniku – Rrënimi i Kullave

Karakteristikat e arkitekturës vernakulare të Kosovës perëndimore është shtëpia e fshatit dy katëshe me galeri të hapur dhe kule-rezidenca madhështore prej gurit e quajtur kulla (Kulla Turke=Kule). Ky lloj i objektit, i cili buron nga koha Osmane, është përhapur nëpër Ballkan por më së shpeshti gjendet në Rrafshin e Dukagjinit, ku është figurë e rëndësishme në fshatërat si Deçan, Junik dhe Nivokaz, poashtu Strelc, Isniq, Batushë dhe Vrellë.

Para konfliktit të armatosur, ekzistonin rreth 500 objekte të tilla. Por shumë prej tyre ishin qëlluar dhe djegur duke u shëndërruar në gërmadha gjatë 1998/1999.

Kryesisht kullat e Kosovës janë prej shek. XVIII dhe XIX por konstruktimi ka vazhduar edhe gjatë dekadës së parë të shek. të XX. Ato janë ndërtuar për familje të zgjeruara si rezidenca gjysëm të fortifikuara dhe i takojnë kulturës shqiptare. Kulla tradicionale ka tri kate; përdhesa është shfrytëzuar për shtallë, kati i parë e ka dhomën e zjarrit, dhomën e ditës dhe depot dhe në katin e sipërm është dhoma e burrave (oda).

Oda e ka stufën e drunjve, shilte (ulëse) përreth mureve dhe shpesh tavanin e dekoruar me motive të përpunuara. Musafirët e arrijnë këtë kat me shkallë të veçanta. Kati i sipërm ka gjithashtu edhe hajatin dhe galerinë (shpesh prej drurit) me platformë të ngritur. Hajati është i lidhur me nyjen sanitare, e cila është e dalur nga objekti. Kullat janë të ndërtuara me gur të përpunuar të ngjitur me llaç gëlqerorë me kënde dhe korniza rreth hapjeve të mveshura me gur.



During 250 years of construction period, kullas are presented in four varieties and fifteen sub varieties.

This determination and separation is based on

- the kullas gallery type and
- the position of the staircase

Junik - Destruction of Kullas

Characteristic of the vernacular architecture of western Kosovo is the two-story town house with an open gallery and the impressive stone tower-residence called kulla (Turkish kule = tower). This type of building, which stems from the Ottoman era, is spread throughout the Balkans but is frequently found on the Dukagjini Plateau, where it is a significant feature in villages such as Deçan, Junik and Nivokaz but also Strelc, Batushe and Vrelle.

Before the armed conflict, some 500 of these buildings still existed. Most of them were however shelled and burned into ruins in 1998/1999.

The Kosovo kullas are predominantly from the XVIII and XIX centuries but were still constructed during the first decades of the XX century. They were built for extended families as semi-fortified residences and belong to the Albanian culture. The traditional kulla has three stories; the ground floor is used as a stable, the first floor has fire room, a living room and a store, and the upper floor is the men's room (oda).

The oda has a fireplace, low benches along the walls and often a decorated ceiling with elaborate patterns. Guests can reach this floor by separate stairs. The top floor has also a vestibule and a gallery (often in wood) with a raised platform. The vestibule is connected to a sanitation point, which is extended from the building. The kullas are built in rubble stone set in lime mortar with corner and frames around openings in dressed stone.



Tipologjia e kullave në bazë të tipeve të DYSHEKLLËKUT (Galerisë)

Kulla me dyshekllek të drurit

Këto lloje të kullave janë më të vjetrat, të ndërtuara në mes të shek. XVIII - XIX. Dyshekllek është shtesa që del jashtë perimetrit të murit, zakonisht në katin e sipërm të kullës dhe ka platformën prej 70 cm përmbi pllakën e dyshemesë që shkon deri në kulm

Ky tip i ka edhe disa nën tipe:

- Dysheklleku i drurit del jashtë perimetrit të murit përgjatë murit gjatësor të fasadës së divanhanes dhe përgjatë fasadave anësore deri te muri i odës së burrave.
- Dysheklleku me mur druri del jashtë perimetrit të murit përgjatë murit gjatësor të fasadës së divanhanes dhe përgjatë fasadave anësore deri te muri i odës së burrave.
- Dysheklleku me mur druri del jashtë perimetrit të murit përgjatë murit në formë të këndit të nxjerrur.
- Dysheklleku me mur druri del jashtë perimetrit të murit përgjatë murit gjatësorë të fasadës së divanhanes dhe përgjatë fasadave anësore si konzollë.

Kulla me dyshekllek me mur të gurit

Ky tip i ka poashtu edhe disa nën tipe:

- Dysheklleku me mur të gurit del jashtë perimetrit të murit përgjatë murit gjatësor të fasadës së divanhanes dhe përgjatë dy fasadave anësore deri te muri i odës së burrave.
- Dysheklleku me mur të gurit del jashtë perimetrit të murit përgjatë murit gjatësor të fasadës së divanhanes dhe përgjatë një fasade anësore deri te muri i odës së burrave.
- Dysheklleku me mur të gurit del jashtë perimetrit të murit përgjatë murit gjatësor të fasadës së divanhanes.
- Dysheklleku me mur të gurit del jashtë perimetrit të murit përgjatë murit në formë të këndit të nxjerrur.
- Dysheklleku me mur të gurit del jashtë perimetrit të murit përgjatë murit si konzollë.
- Dysheklleku me mur të gurit del jashtë perimetrit të murit përgjatë murit në formë të këndit të nxjerrur dhe si konzollë.

Kulla me dyshekllek me mure të kombinuara

Ky lloj i Kullës ka dyshekllekun me mur të drurit që del prej perimetrit të murit dhe është i kombinuar me konzollë dhe mur të gurit të dyshekllekut që gjithashtu del prej perimetrit të murit në formë të këndit të nxjerrur (Shembull Kulla e Kuklecëve në Isniq).

Divanhane është lloj i hollit para odës së burrave dhe është e lidhur direkt me dyshekllek. Oda e burrave është në traditën Shqiptare dhoma e dedikuar për tubimet e burrave.

Typology of Kullas based on DYSHEKLLËK (Gallery) Types

Kulla with a Wooden Gallery

These types of kullas are the oldest, they were built between the XVIII – XIX century. Dyshekllek (eng. – gallery) is an extension that comes out of the perimeter of the wall, usually on the upper floor of the kulla and has a platform of 70cm above the floor slab and goes up to the hip.

This type has some subtypes:

- The wooden gallery comes out from the perimeter of the wall through the longitudinal facade of the divanhane and through two lateral facades to the wall of the oda e burrave.
- The wooden wall gallery comes out from the perimeter of the wall through the longitudinal facade of the divanhane and through one lateral façade to the wall of oda e burrave.
- The wooden wall gallery comes out from the perimeter of the wall in the form of an extruded corner.
- The wooden wall gallery comes out from the perimeter of the wall through the longitudinal facade of the divanhane and through two lateral facades with a console.

Kulla with a Stone Wall Gallery

This type also consists of some subtypes:

- The stone wall gallery comes out from the perimeter of the wall through the longitudinal facade of the divanhane and through two lateral facades to the wall of the oda e burrave.
- The stone wall gallery comes out from the perimeter of the wall through the longitudinal facade of the divanhane and through one lateral façade to the wall of the oda e burrave.
- The stone wall gallery comes out from the perimeter of the wall through the longitudinal facade of the divanhane.
- The stone wall gallery comes out from the perimeter of the wall in the form of an extruded corner.
- The stone wall gallery comes out from the perimeter of the wall as a console.
- The stone wall gallery comes out from the perimeter of the wall in the form of an extruded corner and a console.

Kulla with a Combined Wall Gallery

This type of Kulla has a wooden wall gallery that comes out from the perimeter of the wall and is combined with a console and a stone wall gallery that comes also out from the perimeter of the wall as kind of an extruded corner. (Example: Kulla e Kuklecve in Isniq).

Divanhane is a kind of entering hall to the oda e burrave and is directly connected to the gallery. Oda e burrave is an Albanian traditional room dedicated for men's gatherings.

Kulla me dyshekllek me mur të gurit që nuk del jashtë perimetrit të murit

Ky tip i ka edhe disa nën tipe:

- Dysheklleku me mur të gurit vazhdon përgjatë murit gjatësorë të fasadës së divanhanes dhe përgjatë dy fasadave anësore deri te muri i odës së burrave.
- Dysheklleku me mur të gurit vazhdon përgjatë murit gjatësor të fasadës së divanhanes dhe përgjatë një fasade anësore deri te muri i odës së burrave.
- Dysheklleku me mur të gurit shtrihet në njërin kënd të objektit.
- Dysheklleku i gurit përfshin fasadën e tërë.

Tipologjia e kullave në bazë të tipeve të shkallëve

Bazuar në dizajnin arkitektural të shkallëve, kulla mund të kalsifikohet në:

- Kulla me shkallë të brendshme dhe të jashtme. Ky tip i takon gjysmës së dytë të shek. XVIII dhe fillimit të shek. XIX.
- Kullat me një palë shkallë të drurit të brendshme. Ky tip i takon gjysmës së dytë të shek. XIX.
- Kullat me dy palë shkallë të brendshme. Ky është tip unik i zonës së Dukagjinit.



046

047

Kulla with a Stone Wall Gallery that does not come out from the Perimeter of the Wall

This type also consists of some subtypes:

- The stone wall gallery continues through the longitudinal facade of the divanhane and through two lateral facades to the wall of the oda e burrave.
- The stone wall gallery continues through the longitudinal facade of the divanhane and through one lateral façade to the wall of the the oda e burrave.
- The stone wall gallery extends on one corner of the building.
- The stone wall gallery involves the entire façade.

Typology of Kullas based on STAIRCASE Types

Based on the architectural design of the stairs, kullas can be classified:


- Kullas with indoor and outdoor staircases. This type belongs to the second half of the XVIII and the beginning of the XIX century.
- Kullas with one indoor wooden staircase. This type belongs to the second half of the XIX century.
- Kullas with two indoor staircases. This is a unique type of Dukagjin area.



Pyetësoret - Të arriturat e turizmit - Resurset


Shumica e banorëve do të investonin në turizëm

- 410 po	89,32 %
- 15 jo	3,27 %
- pa përgjegje	7,41 %




Të pyetur se a mendojnë që kanë çkado interesante për turistët , si shtëpi, oborr, objekt artistik, kafshë etj, ata u përgjigjën

- 183 po	39,87 %
- 240 jo	52,29 %
- pa përgjegje	7,84 %




Shumica e njerëzve do të ishin shumë të interesuar të ofrojnë shërbime të fjetjes dhe mëngjesit për turistët që vijnë në Junik.

- 184 njerëz u përgjigjën me po	40,09 %
- 73 mjaft të interesuar	15,90 %
- 78 jo shumë të interesuar	16,99 %
- 54 të pa interesuar	11,76 %
- pa përgjegje	15,25 %




On natural heritage they like best the mountains and the Ereniku river.

- mountains	216
- Ereniku river	151
- Moronica	128
- water	100
- air	72
- climate	67
- nature	45
- greenery	38
- Gjeravica	26
- quietness	12
- lakes	10
- geographical position	10
- brooks	4
- agricultural fields	3
- Vajavica	2
- Zabeli (bocage)	1
- Prroni i zi	1



When asked what they didn't like so much in Junik, most mentioned the damaged roads and the bad infrastructure.

- damaged roads	105
- infrastructure	105
- sewage system	80
- lack of electricity	18
- unbuilt river bank	15
- lack of sidewalks	13
- lack of mountain road	3
- bad smell of some brooks	3
- lack of water in summer period	3
- electrical columns	2
- lack of street lights	2
- lack of bridges	1





• Pyetësorët – Ëndërrimi në qiellin e kaltër



Në fund njerëzit janë pyetur se çka do të donin të ndodhte në Junik ose çfarë funksione do të donin të kenë.

Sa i përket mjedisit në Junik:

- Shumë parqe, oborre, objekte kulturore, spitale...
- Vend të pastër me infrastrukturë të zhvilluar
- Vend me ekonomi të zhvilluar, kulturë dhe turizëm
- Vend kulturor, bujqësor dhe turistik
- Ruajtje dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore
- Vend historik – tradicional, kulturor, me muze, kulla dhe me plan urbanistik të përshtatshëm
- Sipërfaqe banimi me objekte të ulta
- Shumë oborre dhe parqe
- Vend i qetë me gjelbërim
- Kombinim të arkitekturës tradicionale dhe moderne
- Përmirësim të hapësirave publike
- Qytet me objekte kulturore, parqe, teatër dhe qendër sportive
- Rindërtim të objekteve të djegura

Sa i përket turistëve:

- Vend turistik me shumë kushte për rekreacion
- Vend ideal për turizëm dhe bujqësi
- Turizëm i bjeshkëve, skijim, ski-lifte...
- Qendra më e preferuar në botë për turistët e jashtëm



Sa iu përket më shumë gjërave të veçanta:

- Vend me shërbime të mira komunale dhe qendër reprezentative
- Vend i pastër me pishina të notit, parqe nacionale, fabrika, objekte të larta, diskoteka, rrugë të bjeshkëve, qendra për të rinjë...
- Fabrika
- Qendra sportive, kinema...
- Qendra skijimi
- Më shumë vende për jetë të natës, diskoteka, pishina të notit, biblioteka...
- Infrastrukturë të mirë, industri të ushqimit...
- Kushte të mira për të gjitha gjeneratat
- Biblioteka
- Kopshte zoologjike
- Hidrocentral

Në përgjithësi njerëzit do të donin që Juniku të jetë:

- Vend si qytetet tjera të Kosovës, apo në botë.....
- Vend turistik me plan urbanistik, bujqësi të zhvilluar, biznese të vogla dhe ekonomi të qëndrueshme
- Ekonomi e zhvilluar

Questionnaires - Blue Sky Dreaming

Finally people were asked what they would wish most to happen in Junik or which functions they would prefer to have here.

Concerning the environment in Junik:

- A lot of parks, gardens, cultural buildings, hospitals...
- Clean place with developed infrastructure
- A place with developed economy, culture and tourism
- Cultural, agricultural and tourist site
- Protection and preservation of cultural heritage
- A historical site – traditional, cultural, with museums, kullas and an appropriate urban plan
- Residential areas with low buildings
- A lot of gardens and parks
- A quiet place with greenery
- A combination between traditional and modern architecture
- Improvement of public spaces
- A city with cultural buildings, parks, theater and sports center
- Rebuild burnt buildings



Concerning tourists:

- Tourist place with a lot of recreational facilities
- Ideal place for tourism and agriculture
- Mountain tourism, skiing, ski-lifts...
- The most preferred center of the world for foreign tourists

Concerning more special things:

- A place with good municipal services and a representative center
- Clean place with swimming pools, national parks, factories, high buildings, discotheques, mountain roads, youth centers...
- Factories
- Sports center, cinema...038s-badminton
- Ski center
- More places for night life, discotheque, swimming pools, library...
- Good infrastructure, food industry...
- Facilities for all generations
- Library
- Zoo
- Hydro electric power plants



Overall people would like to be Junik:

- A place like other cities of Kosova, or in the world.....
- A tourist place with an urban plan, developed agriculture, small businesses and a sustainable economy
- Developed economy



Vëzhgime - Idetë: Ngjarjet e përbashkëta - Largimi i mbeturinave

Duke e marrë parasysh të ardhmen e Junikut, dhe posaçërisht të ardhmen e afërt, për popullatën e komunës do të ishte shumë ndihmuese nëse të gjithë banorët do të punonin së bashku për ta përmirësuar mjedisin e tyre. Pra këto aksione do të mund të shpallen si ngjarje të përbashkëta dhe do të ishin shumë të dobishme.

- të shpallet një ditë si „ngjarje e largimit të bërllotut“ të gjithë njerëzit në aksion të përbashkët do të largojnë mbeturinat nga përrojet, nga rrugët dhe pjesët e gjelbëruara dhe më vonë të festojnë këtë ngjarje së bashku.



Observation - Ideas: Common Events - House Painting

Another opportunity for a combined effort could be the plastering and painting of one of the unfinished houses in the center of Junik. Another way to state that kind of example would be to declare the day as painting day and some of the house owners finish their houses on that day and give a good example for the others.

- declare one day as a „house painting day“ in the evening all should celebrate together and look at the finished houses and the improvements for Junik



Informata gjenerale

Plotësuar nga: **Genc Gafurri**
 Data (dd mm vvvv): **07.05.07**

Lokacioni Kodi

Komuna: **Junik**
 Fshati: **Junik**
 Lagjia: **Bajraktari**
 Numri i parcelës: **1262-0**
 Kodi i objektit: **1262-0_A**

Tiparet kryesore të Kullave Kodi

Emri: **Kulla e Faik Llollunit**
 Koha e ndërtimit: **Rreth 200 vite e vjetër**
 Shfrytëzimi i tanishëm (funksioni): **Banim**

Tipologjia Kodi **Niveli i dëmtimit** Kodi

shpirti	me dru	<input type="checkbox"/>	WO	<input type="checkbox"/>	Pa	<input checked="" type="checkbox"/>	DN
	me gur	<input checked="" type="checkbox"/>	ST	<input type="checkbox"/>	I ulët	<input type="checkbox"/>	DL
shpirti & funksion	të kombinuar	<input type="checkbox"/>	CO	<input type="checkbox"/>	I mesëm	<input type="checkbox"/>	DM
	del jashtë murit rrethues	<input checked="" type="checkbox"/>	OUT	<input type="checkbox"/>	I lartë	<input type="checkbox"/>	DH
shpirti	nuk del jashtë murit rrethues	<input type="checkbox"/>	IN	<input type="checkbox"/>	I shkatërruar	<input type="checkbox"/>	DD
	pa shkallë të jashtme	<input type="checkbox"/>	NOS	<input type="checkbox"/>			
shpirti	injë shkallë e jashtme	<input checked="" type="checkbox"/>	SOS	Note: Varietëti prej nivellit të dëmtimit të kullës, disa prej informatave në këtë tabelë mund të mos plotësohen			
	2 shkallë të jashtme	<input type="checkbox"/>	TOS				

Vlerat e Atributeve Kodi **Sugjerimet e trajtimit** Kodi

kulturore	Identiteti	<input checked="" type="checkbox"/>	IDE	Ruatje	<input type="checkbox"/>	PRO
	Artistike	<input type="checkbox"/>	ART	Mrotje	<input type="checkbox"/>	PRE
	Teknike	<input type="checkbox"/>	TEC	Konservim	<input type="checkbox"/>	CNV
	Rrallësia	<input type="checkbox"/>	RAR	Konsolidim	<input type="checkbox"/>	CND
sociale	Komuniteti	<input type="checkbox"/>	COM	Restaurim	<input type="checkbox"/>	RES
	Edukative	<input type="checkbox"/>	EDU	Rekonstruim	<input type="checkbox"/>	REC
	Politike	<input type="checkbox"/>	POL	Anastiloza	<input type="checkbox"/>	ANA
	Funksionale	<input type="checkbox"/>	FUN	Shënim: Atributet e vlerave të veçanta të objektit mund të kërkojnë një apo më shumë trajtime		
ekonomike	Ekonomike	<input type="checkbox"/>	ECO			

Addressing the need for political support, legislative and institutional coordination and support from central institutions and donor agencies are an important component of strategic spatial planning process. The “inhouse” approach contributed to getting knowing better the planning legislation. However, there is a need for further support within lifetime of the project. Subsequently, getting the political support and contributing to raising awareness and up-lifting planning issues at political agenda is essential.

Edhe pse PZHK i Junikut përballet me ndryshime në nivelin politik për shkak të zgjedhjeve lokale këto nuk ndikojnë në procesin e planifikimit; udhëheqja e re e rikonfirmoi mbështetjen politike për qasjen e planifikimit “në shtëpi”. Projekti në Junik ka kontribuar në forcimin e bashkëpunimit mes Komunës dhe MMPH. Si rezultat i kësaj, Instituti për Planifikim Hapësinor iu bashkua projektit për të kontribuar me ekspertizë profesionale. Procesi i konsultimit në PZHK ka përfshirë edhe institucionet e tjera relevante qeveritare, si dhe komunat fqinje për marrjen e të dhënave për dokumentin dhe harmonizimin e tij me politikën e tyre dhe projektet. Për më tepër, procesi i konsultimit përqipet t'i përfshijë edhe donatorët, bizneset private si dhe OJQ-të në fazën e vlerësimit të kapaciteteve për investimet e mundshme.

3.3 Mangësitë e identikuara

Gjatë zbatimit të kësaj metodologjie është vërejtur se në mesin e të metave kryesore paraqitet faktori kohë dhe nevoja për vlerësimin e saktë të burimeve njerëzore për të kryer këtë proces. Faktori kohor ka të bëjë me procesin e zhvillimit të planifikimit “në shtëpi” e që ka për tendencë të marrë më shumë kohë kur krahasohet me qasjen alternative të nënkontraktimit. Arsyetimi logjik pas tij është se kur nënkontraktohet, kompania fituese konsulente veçse i ka përgatitur burimet njerëzore dhe financiare për të pasur një kontribut të pandërprerë në procesin e hartimit të planifikimit. Derisa qasja “në shtëpi” varet gjerësisht mbi disponueshmërinë e anëtarëve të GPK-së të cilët mjaft shpesh kanë detyra të tjera për të kryer. Kjo është ngushtë e lidhur me mungesën e komponentit të njësisë për politikën e planifikimit në kuadër të strukturës së drejtorisë së urbanizimit, kryesisht për shkak të kufizimeve të vendosura nga qeveria qendrore dhe që rrjedhin nga rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Një tjetër vështirësi në aplikimin e qasjes së Junikut është se kjo metodologji është shumë kërkuese për organizatat që japin asistencë teknike si dhe komunën. Rrjedhimisht, të gjithë ata kanë nevojë për vlerësim të kujdesshëm të burimeve njerëzore, kapaciteteve, dhe përvoja e komunës (në veçanti Drejtoria e Planifikimit Urban) dhe kapacitetet e organizatave në procesin e planifikimit hapësinor si plan-zhvillimi i PZHK-së është tejet konsumuese në aspektin profesional dhe financiar.

Për më tepër, çështja e pagave dhe i kategorizimit në nivelin komunal vazhdojnë të mbeten një faktor sfidues e të cilat janë konsideruar të jenë shumë të ulëta dhe të pamjaftueshme për të tërheqjen dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar dhe me përvojë për një funksionim efikas të GPK-së.

4 PËRFUNDIMI DHE MËSIMET E NXJERRA

Komunat luajnë një rol të rëndësishëm në udhëheqjen e komunitetit të tyre, në krijimin e të mirave dhe forcimin e identitetit lokal. Shoqëria duhet të ketë një udhëheqje të fuqishme që mbledh së bashku të gjitha palët e interesuara relevante, përfaqësuesit e komunitetit dhe ata të biznesit, shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare, të cilët mund të ndihmojnë në zhvillimin e një strategjie të bazuar në një vizion të përgjithshëm. Kjo është njëra prej aktiviteteve më të rëndësishme që komunat pritet të zhvillojnë. Është interesante të përmendet se në rrethanat e tanishme roli i agjencive ndërkombëtare (të tilla si UN-HABITAT-i) është më i madh se ç'pritej për shkak të granteve të donatorëve, deri në atë pikë sa që është marrë në konsideratë si një palë e interesit në tërë këtë proces.

Although, Junik MDP faces changes at political level due to local elections, that didn't affect the planning process; the new leadership reaffirmed political support to the “in-house” planning approach. The project in Junik has contributed to strengthening cooperation between the municipality and MESP. As an outcome, the Institute for Spatial Planning joined the project to contribute with professional expertise. The consultation process on the MDP involved also other relevant governmental institutions as well as neighbour municipalities for getting the input to the document and harmonise it with their policies and projects. Furthermore, the consultation process seeks to involve also donors, private businesses and NGO's in the phase of assessing the capacities for potential investments.

3.3 Shortcomings identified

In applying this methodology it is noted that amongst the key shortcomings is the time factor and the need for exact evaluation of human resources to carry out the process. Timeline factor relates to the process of 'in-house' plan-making which tends to take longer when compared to alternative outsourcing approach. The logical reasoning behind is that when outsourced the winning consultant company has prepared human and financial resources to have a non-stop input into the planmaking process. While, the 'in-house' approach depends widely on the availability of the MWG members which quite often have other duties to perform. This is linked to the missing component of planning policy unit within the structure of urbanism directorate, mainly due to limitations imposed from central level government and deriving from recommendations of International Monetary Fund.

Another difficulty in applying Junik approach is that this approach is very demanding for organisations providing technical assistance and municipality. Thus, they all need to assess carefully the human resources, capacities, and experience of the municipality (especially Urban Planning Directorate) and organisations capacity in spatial planning process as MDP plan-making is a very demanding in professional and financial terms.

Moreover, stil remans a challenging factor the issue of salaries and grades at municipal level which are considered to be too low and too little to attract and retain qualified and experienced staff for the efficient operation of the MWG.

4 CONCLUSION & LESSONS LEARNED

Municipalities play an important role on leading their communities, creating wealth and enforcing the local identity. The society needs to have a strong leadership that brings together all relevant stakeholders, community and business representatives, civil society and international organisations which can contribute in developing a strategy based on an overall vision. This is one of the crucial activities that municipalities are expected to conduct. It is interesting to note that under current circumstances the role of international agencies (such as Un-HABITAT) is larger than expected due to donor grants, to a point that it is consider a stakeholder in the process.

Megjithatë, me kalimin e kohës dhe me rritjen e nivelit të kapacitetit profesional dhe financiar të komunave, roli i agjencive ndërkombëtare do të duhet të reduktohet në atë të vetëm nxitësit të proceseve dhe projekteve. Përvoja nga e kaluara, planifikimi i fundit i para konfliktit (ku shumica e mjeteve ishin në pronësi shtetërore) mbështetej në atë që pushteti lokal do të lehtësonte dhe do t'i siguronte të gjitha këto aktivitete vetë. Ndërsa, planifikimi strategjik bashkëkohor promovon qasjen me të cilat qeverisja lokale pritet të kryejë shumicën e aktiviteteve të saj në partneritet me sektorin privat dhe agjencive ndërkombëtare, me përfshirjen e vazhdueshmë të zërit të komunitetit. Në këtë drejtim, qasja e Junikut për PZHK-në (edhe pse procesi nuk ka përfunduar) është unike dhe pavarësisht nga disa të meta të vogla ajo shpaguhet gjatë hartimit të dokumentit të politikave “në-shtëpi”.



5 REFERENCAT

- D'hondt, F:** Re-Creating Kosovo Cities, 42nd ISoCaRP Congress, 2006.
- Garstka, G. J:** Building a whole state with half the people: issues of illegal construction, informal neighbourhoods, and rights to the city in post-conflict Kosova/o. *Infinity Journal*, 1 (2), 2009.
- Gashi, Lumnije:** Assessing capacities of local planning departments and addressing their needs in managing Municipal Development Plan preparation process, Case of Gjakova and Shtime municipality. Erasmus University and Institute for Housing and Urban Studies, Rotterdam, 2005 [unpublished].
- Hercher, A:** Urbicide, Urbanism, and Urban Destruction in Kosovo. *Theory & Event*, Volume 10, 2, 2007.
- Hirt, S. & Stanilov, K:** Twenty years of transition: the evolution of urban planning in Eastern Europe and the former Soviet Union, 1989-2009. *UN-HANITAT Human Settlements Global Dialogue*, no 5, 2009.
- Kosovo Stability Initiative / European Stability Initiative:**
- Utopian Visions:** Governance failures in Kosovo's capital. Discussion paper: 8 June 2006. Available from: http://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_78.pdf; accessed on 10/03/2010.
- Ludeking, G:** Inclusive and strategic planning in Kosovo. Habitat debate, 2004.
- MESP:** Kosovo Spatial Plan 2009-2025. Prishtina, 2009.
- MESP:** Report on the condition of planning and spatial management for Kosovo municipalities. Prishtina, 2006.
- MESP:** Law on Spatial Planning. Prishtina, 2003.
- UN-HABITAT:** Inclusive and Sustainable Urban Planning: A Guide for municipalities. Volume 1: An Introduction to Urban Strategic Planning. Prishtina, 2007


Nonetheless, as time passes and the municipalities show increased levels of professional and financial capacity, the role of international agencies will have to be reduced to only stimulate processes and projects. The experience in the past, pre-conflict planning (where most of assets were state owned) was that local government would facilitate and provide all these activities themselves. Whereas, contemporary strategic planning promotes the approach by which local government are expected to conduct most of its activities in partnership with private sector and international agencies, while consistently involving voices of community. In this respect, Junik approach to the MDP (although not yet completed process), is unique and despite some minor drawbacks, it pays off when devising policy document in-house.



5 REFERENCES

- D'hondt, F:** Re-Creating Kosovo Cities, 42nd ISoCaRP Congress, 2006.
- Garstka, G. J:** Building a whole state with half the people: issues of illegal construction, informal neighbourhoods, and rights to the city in post-conflict Kosova/o. *Infinity Journal*, 1 (2), 2009.
- Gashi, Lumnije:** Assessing capacities of local planning departments and addressing their needs in managing Municipal Development Plan preparation process, Case of Gjakova and Shtime municipality. Erasmus University and Institute for Housing and Urban Studies, Rotterdam, 2005 [unpublished].
- Hercher, A:** Urbicide, Urbanism, and Urban Destruction in Kosovo. *Theory & Event*, Volume 10, 2, 2007.
- Hirt, S. & Stanilov, K:** Twenty years of transition: the evolution of urban planning in Eastern Europe and the former Soviet Union, 1989-2009. *UN-HANITAT Human Settlements Global Dialogue*, no 5, 2009.
- Kosovo Stability Initiative / European Stability Initiative:**
- Utopian Visions:** Governance failures in Kosovo's capital. Discussion paper: 8 June 2006. Available from: http://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_78.pdf; accessed on 10/03/2010.
- Ludeking, G:** Inclusive and strategic planning in Kosovo. Habitat debate, 2004.
- MESP:** Kosovo Spatial Plan 2009-2025. Prishtina, 2009.
- MESP:** Report on the condition of planning and spatial management for Kosovo municipalities. Prishtina, 2006.
- MESP:** Law on Spatial Planning. Prishtina, 2003.
- UN-HABITAT:** Inclusive and Sustainable Urban Planning: A Guide for municipalities. Volume 1: An Introduction to Urban Strategic Planning. Prishtina, 2007

2011
 PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL 2010 - 2023
 MUNICIPAL DEVELOPMENT PLAN 2010 - 2023



EKIPI PUNUES KOMUNAL / MUNICIPAL WORKING TEAM

- Faik Tofaj** - Drejtor i Drejorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mjedisit, Komuna Junik / Director of Urbanism, Cadastre and Environment, Municipality of Junik
Ferdone Tofaj - i.d. arkitekturës Udhëheqëse e Projektit, Komuna Junik / architect, Project Leader, Municipality of Junik
Arten Hamza - ekonomist, Drejtor për Ekonomi & Financa, Komuna Junik / economist, Director of Economy and Finances, Municipality of Junik
Flurije Shehu - Gjeodet, Zyrtare për Kadastër, Komuna Junik / geodet, Cadastre official, Municipality of Junik
Xhemë Shehu - Gjeodet, Zyrtar për Gjeodezi, Komuna Junik / geodet, Geodesy official, Municipality of Junik
Xhavit Jasiqi - i.d. Ndërtimtarisë, Zyrtar për urbanizëm, kadastrë, mjedis, Komuna Junik / construction eng., Urbanism, Cadastre and Environment official, Municipality of Junik
Ali Gacaferi - ing. Bujqësisë, Zyrtar për Bujqësi & Zhvillim Rural, Komuna Junik / agricultural eng., Agriculture and Rural Development official, Municipality of Junik
Shkodran Gaxherri - i.d. bujqësisë / agricultural eng.,
Xhavit Velijaj - i.d. makinerisë / mechanical eng.,
Visar Tofaj - Ekonomist, Zyrtar për Zhvillim Ekonomik, Komuna Junik / Economist, Economist Development Official, Municipality of Junik
Blerta Shehu - ekonomiste, zyrtare për ekonomi, Komuna Junik / economist, Economy official, Municipality of Junik
Avdyl Gjota - ekonomist, Menaxher i Tatimit në Pronë, Komuna Junik / Economist, Property taxes Manager, Municipality of Junik
Arton Krasniqi - Zyrtar për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna Junik / Culture, Youth and Sports official, Municipality of Junik
Shkelzen Shehu - Udhëheqës i njësisë zjarrfikëse, Komuna Junik / Fire Brigade Unit Leader, Municipality of Junik
Suzana Krasniqi - Juriste, Zyrtare ligjore, Komuna Junik / Jurist, Law official, Municipality of Junik
Ali Kuqi - Mjek / Doctor
Mirishahe Krasniqi - Banorë, OJQ "Rrënja" / Citizen, NGO "Rrënja"
Ibrahim Kryeziu - EULOg / EULOg
Freskina Isufaj - Juriste / jurist
Halit Haxhiu - Ndërtimtar / constructor
Zeqë Shehu - Banorë, Komuna Junik / Citizen, Junik Municipality

EKIPI I BASHËPUNËTORËVE / COLLABORATORS TEAM

- Lumnije Gashi** - i.d Ark.MA në Menaxhim dhe Zhvillim Urban Planifikues Hapësinor, MuSPP/UN-HABITAT / arch.MA Management and Urban Development Space Planner, MuSPP / UN-HABITAT
Dukagjin Bakija - Bsc., DipTP., MSc. Planifikim Urban, Udhëheqës Projekti, MuSPP/UN-HABITAT / Bsc., DipTP., MSc. Urban Planning, Project Leader, MuSPP/UN-HABITAT
Enes Toska - i.d. arkitekturës, Udhëheqës Projekti, CHWB/arch., Project Leader, CHWB
Teuta Jaha - i.d. arkitekturës, Planifikues Hapësinor, MuSPP/UN-HABITAT / arch., Space Planner, MuSPP/UN-HABITAT
Caroline Johansson - Arkitekt Peisazhi, Zyrtarë i programit MuSPP/UN-HABITAT / Landscape arch., MuSPP/UN-HABITAT programme official
Festa Nela - i.d. arkitekturës, Instituti për Planifikim Hapësinor, MMPH / architect, Institute of Spatial Planning, MESP
Shpend Agaj - gjeograf, Instituti për Planifikim Hapësinor, MMPH, geographer, Institute of Spatial Planning, MESP
Ismajl Gagica - Gjeograf, GIS Ekspert, Instituti për Planifikim Hapësinor, MMPH / Geographer, GIS Expert, Institute of Spatial Planning, MESP

EKIPI MBËSHTETËS / SUPPORTING TEAM

- Tor Eriksson** - ark. planer, këshilltar në MuSPP/UN-HABITAT / architect, planner, consultant, MuSPP/UN-HABITAT
Joachim Bergerhoff - transport planner, Ekspert për transport MuSPP/UN-HABITAT / transport planner, transport expert, MuSPP/UN-HABITAT
Rudina Qerimi - i.d.a arkitekthe, MuSPP/UN-HABITAT / architect MuSPP/UN-HABITAT
Arijeta Himaduna - MuSPP/UN-HABITAT / MuSPP/UN-HABITAT
Gloriosa Hisari - Juriste, MuSPP/UN-HABITAT / Jurist, MuSPP/UN-HABITAT

KONSULTANTË TË JASHTËM / EXTERNAL CONSULTANTS

- Idriz Shala** - GIS ekspert / GIS expert
Tush Markaj - Ekspert i Mjedisit / Environment expert
Pëllumb Gjinolli - Ekspert i Mjedisit / Environment expert

150

151

PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE RËNDËSIA E TIJ

Planifikimi Hapësinor si disiplinë multisektorale dhe proces i referohet hapësirës e cila na rrethon dhe në të cilën bashkëveprojmë duke i dhënë shprehje gjeografike politikave ekonomike, sociale, kulturore dhe atyre ekologjike/mjedisore të shoqërisë. Sipas Komunitetet Europiane (1997), planifikimi hapësinor i referohet metodave që përdoren nga sektori publik për të ndikuar në shpërndarjen e aktiviteteve në hapësirë.

Në Kosovë, korniza për zhvillim hapësinor është e përcaktuar me Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe akteve përcjellëse që dalin nga ai. Me këtë legjislacion përcaktohen përgjegjësitë dhe kompetencat në fushën e planifikimit, parimet të cilat duhet respektuar gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit, procedurat e shqyrtimit publik dhe pjesëmarrjes e përfshirjes së akterëve të ndryshëm në procesin e planifikimit. Kurse Plani Hapësinor i Kosovës jep orientimet dhe udhëzimet e ardhshme të zhvillimit hapësinor të Kosovës dhe udhëzimet për hartimin e planeve zhvillimore komunale.

Plani Zhvillimor Komunal (PZH) i Junikut si plan me karakter strategjik multisektoral përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor të komunës dhe përfshin periudhën 15 vjeçare. Për shkak të harmonizimit të zhvillimeve hapësinore në nivel të Kosovës, ky plan duhet të jetë në përputhshmëri me Planin Hapësinor të Kosovës. Plani Zhvillimor i komunës duhet të kuptohet më shumë se sa vetëm shfrytëzim i tokës, meqë ai ka të bëjë më shumë me një strategji të integruar për rregullimin e ardhshëm të hapësirës, duke përcjellur një vizion të qartë për të cilin është arritur pajtueshmëri si dhe zotim të palëve me interes për të punuar drejt arritjes së qëllimeve dhe orientimeve strategjike që përcjellin atë vizion.

Dhe duke qenë në rolin e harminizuesit dhe udhëzuesit të zhvillimeve të ardhshme në komunë në sferat e ndryshme, dhe i orientuar kah veprimi, PZH ofron mundësi për marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e hapësirës, përcaktimin e regjimit të mbrojtjes dhe zhvillimit të saj dhe vendosjes së veprimtarive ekonomiko-sociale e mjedisore në territorin e Komunës së Junikut. Rëndësia e veçantë e PZH për shkak të qasjes integruese gjatë hartimit të tij dhe karakterit multisektoral që ka, qëndron edhe në atë se ky plan duhet të tentojë të minimizojë konfliktet ndërsektorale dhe vë në pah përparësitë dhe potencialin zhvillimor të Junikut.



SPATIAL PLANNING AND ITS IMPORTANCE

The Spatial Planning is a multi-sectional discipline and process that refers to the space which surrounds us and in which we interact giving the geographical expression to the economic, social, cultural and ecological /environmental policies of the society. According to the European Community (1997), spatial planning refers to methods used by the public sector to influence the distribution of activities in the area.

In Kosovo, the spatial development framework is defined by the Law on Spatial Planning and the accompanying acts arising from it. This legislation defines the responsibilities and authorities in the field of planning, the principles that must be respected during the development of planning documents, review procedures and public participation and involvement of different stakeholders in the planning process. Whereas, Kosovo Spatial Plan provides guidelines and future directions of spatial development of Kosovo and guidelines for drafting local development plans.

Municipal Development Plan (MDP) of Junik as multi-sectional strategic plan sets long-term goals of economic, social and spatial development of the municipality and includes 15-year period. Due to the synchronization of spatial developments in Kosovo level, this plan should be consistent with the Spatial Plan for Kosovo. Municipal Development Plan is to be understood more than just land use, since it has more to do with an integrated strategy for the future regulation of space, following a clear vision for which the agreement and commitments of the stakeholders were reached in working towards achieving the goals and strategic directions that follow that vision.

And being in the role of synchronizer and the guide for future developments of the municipality in a range of areas and action oriented, MDP provides an opportunity for decision-makings concerning the spatial use, determining the regime of protection and its development; and placing social-economic activities in the territory of the Municipality of Junik. A special importance of the MDP because of the integrated approach during its design and multi-sectoral character that it carries is that this plan should attempt to minimize inter-sectoral conflicts and highlights the advantages and development potentials of Junik.



QËLLIMET E PZHK-se JUNIKUT

Qëllimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) është të jap vizion dhe synime të qarta për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të komunës dhe përcaktojë programet, politikat zhvillimore dhe veprimet për të arritur synimet e përcaktuara. Kah do të orientohet banimi, si të ruhen por edhe zhvillohen resurset natyrore dhe vlerat e trashëgimisë kulturore në dobi të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale, si të lehtësohet qarkullimi i banorëve por të ofrohet edhe qasje më e lehtë për vizitorë, etj janë disa nga çështjet për të cilat PZHK ofron zgjidhje. Komuna e Junikut është komunë e vogël shikuar nga aspekti demografik dhe territorial por me mundësi dhe potencial për zhvillim, falënderuar pozitës ndërkuftare dhe potencialit natyror që posedon, ruajtjes së traditave dhe trashëgimisë kulturore e mbi të gjitha popullatës së re dhe entuziaste për përparimin e komunës. PZHK synon që këtë potencial ta ruajë, zhvillojë në mënyrë të qëndrueshme e racionale dhe promovojë në interes të Junikasve por edhe interes kombëtar. Plani përcakton projektet me prioritet, që do të kryhen për qëllime publike, andaj duhet t'i shërbejë si bazë komunës për negociata me palë të ndryshme, siç janë ministritë apo investitorët privat për zbatimin e projekteve komunale në mënyrë strategjike.


Synim tjetër i procesit të hartimit të PZHK shikuar nga aspekti institucional, është të kontribuojë edhe në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe organizative në fushën e planifikimit strategjik hapësinor, marrë parasysh faktin që ky është plani i parë hapësinor për komunën dhe komuna e Junikut është komunë e re e themeluar në vitin 2008.



GOALS OF MDP OF JUNIK

The purpose of the Municipal Development Plan (MDP) is to give clear vision and goals for the future spatial development of municipality and defining programs, development policies and actions to achieve targets set. Some of the issues for which the MDP offers solutions are where the housing shall be oriented but also the development of natural resources and cultural heritage values in favor of economic growth and social welfare, ways to facilitate movements of people but also providing easier access for visitors, etc. Municipality of Junik is a small municipality in demographic and territorial terms but with opportunities and potential for development thanks to the geographical and cross-border position, preservation of the cultural and custom heritage, and above all the young population enthusiastic about the progress of the municipality. MDP aims to maintain this prospective, developing it in a sustainable and rational manner and promote it in favor of the inhabitants of Junik and the national interest. The plan sets out the priority projects to be carried out for public purposes; therefore, it should serve as the basis of the municipality for negotiations with different parties such are ministries or private investors to implement municipal projects strategically.

Another goal of the process of drafting the MDP in institutional viewpoint is contribution to the development of human and organizational capacities in strategic spatial planning, taking into account the fact that this is the first spatial plan for the municipality and the Municipality of Junik is newly fledged municipality established in 2008.




PROCESI I PLANIFIKIMIT DHE METODOLOGJIA

Procesi i hartimit të Planit Zhvillimor të Junikut pikënisje ka ligjin për planifikimi hapësinor i cili përcakton parimet e pjesëmarrjes dhe përfshirjes si dhe kornizën e procesit të hartimit të planit përfshirë edhe marrjen e vendimit nga Kuvendi Komunal më 27 Mars 2009, vendimi numër 001/14. Sipas ligjit, qasja në planifikimin hapësinor dhe urban dhe procesi i hartimit të planeve duhet të jenë në përputhshmëri me parimet e pranuar ndërkombëtare për zhvillim urban dhe qeverisje të mirë duke vënë theks të veçantë në parimet si: transparencja, zhvillimi i qëndrueshëm, pjesëmarrja publike dhe gjithpërfshirja, ofrimi i mundësive të barabarta për të gjithë pa dallim moshe, gjinie, etniteti etj.

Për të garantuar pjesëmarrjen publike gjatë procesit të hartimit të planit, komuna ka vendosur që përveç të qenit bartëse e këtij procesi, të jetë në të njëjtën kohë edhe hartuese PZHK.

Në këtë proces komuna është përkrahur nga Programi për Përkrahjen e Komunave në Planifikim Hapësinor në Kosovë i UN-HABITAT-it i financuar nga Sida, Organizata “Trashëgimia Kulturore pa Kufij” dhe si dhe Instituti për Planifikim Hapësinor nga MMPH. Ky bashkëpunim rezultoi me dokumentin e përpiluar bashkërisht si dhe me përfshirjen e pjesëmarrësve të ndryshëm dhe palëve me interes në gjithë procesin e planifikimit. Esencialja në këtë proces është zhvillimi i sensit të pronësisë si dhe përgjegjësisë për vendimet dhe për krijimi i bazës për bashkëpunim dhe partneritet.

E fundit por jo më pak e rëndësishme, është se qasja e hartimit të këtij dokumenti në mënyrën “të mësojmë duke punuar” do t’iu jap mundësinë të gjithë pjesëmarrësve në këtë proces të ngrisin edhe më tej kapacitetet e tyre duke mësuar e punuar së bashku dhe shkëmbyer ide me njëri tjetrin. Etapat dhe përfshirja e pjesëmarrësve në periudha të caktuara gjatë hartimit të PZHK (shih më gjerësisht raportin e procesit të përfshirjes dhe pjesëmarrjes) anë paraparë sipas kornizës së zhvilluar (shih grafiku 1).



PROCESS OF PLANNING AND METHODOLOGY

The process of drafting the MDP Junik as a starting point has the Law on Spatial Planning which sets the principles of participation and inclusion as well as the framework of the drafting process including the decision brought by the Municipal Assembly on 27 March 2009, decision number 001/14. By the law, access to spatial and urban planning and the process of drafting the plans must be in accordance with internationally accepted principles for urban development and good governance by bringing a particular emphasis on principles such as transparency, sustainable development, public participation and inclusion, providing equal opportunities for all regardless of age, gender, ethnicity etc.

To ensure public participation in drafting the plan, the municipality has decided that in addition of being the bearer of this process, at the same time be the drafter of MDP.

In this process the municipality is supported by the Municipal Spatial Planning Support Programme in Kosovo (MuSPP) of UN-HABITAT and funded by SIDA, the “Cultural Heritage without Borders” and the Institute for Spatial Planning of the MESP. This cooperation resulted in a mutually drafted document and with the involvement of various participants and stakeholders throughout the planning process. Essential to this process is the increase of a sense of ownership and responsibility for decisions and for establishing the grounds for cooperation and partnership. Last but not least, is that the “learning-by-doing” approach of drafting this document will give opportunity to all participants in this process to further increase their capacity to learn and work together, and exchange ideas with each other. Stages and involvement of participants in certain periods during the development of MDP (see report on the process of inclusion and participation) are provided by the developed framework. (see Figure 1).

Figure 1. Framework developed for the drafting of the MDP for Junik:



HISTORIKU I JUNIKUT

Sipas historisë, Juniku së pari ishte pjesë e Dardanisë Ilire, më pas e Perandorisë Romake, Bizantine e më vonë në kuadër të Perandorisë Osmane. Materialet arkeologjike të zbuluara me gjetje rasti ose kërkime të tërthorta të terrenit, vendbanimi antik “Gradina” i zbuluar në grykën e majës së Gjeravicës së bashku me materialin epigrafik të gjetur në këtë vendbanim, si dhe një mori vendbanimesh tjera të Junikut, mbetjet antike të gjetura në rrafshin aluvial të Erenikut, etj dëshmojnë se Juniku ka qenë një vendbanim ilir.

Të dhënat arkeologjike të shekujve VIII-X, tregojnë se në ato vise, ku nuk është vendosur kolonizimi sllav, ka lulëzuar një kulturë thjeshtë shqiptare, që është quajtur kultura e Komanit, emër ky i një fshati në luginën e Rrafshit të Dukagjinit.

Gjatë kohës se feudalizmit të zhvilluar, Juniku sikurse Gjakova e rrethinat e saj si dhe tërë Kosova, ishin përfshirë në shtetin feudal Serb. Në kohën e Mbretërisë së Jugosllavisë, shqiptarët ishin shumicë dërmuese e popullsisë në rrethinën e Junikut, por që është shoqëruar me migrime masive të popullsisë, të shkaktuara nga ngjarjet historike, ekonomike, politike, etj.

Në fillim të sundimit osman, bazuar në defterët osmanë, përkatësisht në ata të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, Juniku ishte fshat shumë i madh dhe sikurse Gjakova ishte krijuar para ardhjes së këtij sundimi. Juniku deri më 26.IX.1462 qeverisej nga Leka i III-të Dukagjini. Në këtë kohë, Juniku edhe pse ishte fshat, përshkruhet si qendër pazari ashtu sikur Gjakova. Njihej me emrin Lunik dhe po ashtu ishte edhe qendër e kazasë Alltun-Ilia me gjithsej 52 shtëpi.

Gjatë shekujve XV-XVI, kisha ortodokse serbe e cila pranoi vasalitetin e sulltanit, përpiquej në çdo mënyrë t'i serbizojë shqiptarët ortodoksë, dhe t'i ortodoksojë ata katolikë. Islamizimi i popullsisë së Junikut ishte një goditje e rëndë për pozitat e kishës ortodokse serbe, pasi popullsia e Junikut dhe rrethinat e saj ishin islamizuar, në këmbim të lejimit të ekzistencës të kishës së Deçanit. Kështu në vitin 1570-1571, në Junik ndërtohet xhamia e parë në lagjen Çoku e emërtuar sipas lagjes. Më vonë u ndërtua edhe Xhamia në lagjen Hoxha në qendër të fshatit. Islamizimin e përqaftuan edhe një pjesë e aristokracisë shqiptare për ti ruajtur privilegjet e veta klasore. Nga fundi i shek. XVI, rrethina e Altun-ilu, Peja e Gjakova janë përfshirë në kufijtë e Sanxhakut të Dukagjinit. Kjo gjendje është ruajtur edhe gjatë shekullit XVII-të.

Gjatë viteve 1945-1960 Juniku ekziston si komunë. Ndryshimet politike të sistemit të atëhershëm rezultuan me suprimimin e komunës së Junikut në vazhden e ristrukturimit të qeverisjes lokale (eliminohen rrethet), me ç'rast Juniku inkorporohet brenda komunës së Deçanit. Më 22 korrik 2005, nënshkruhet Urdhëresa Administrative të UNMIK-ut nr. 2005/11 për themelimin e pesë Pilot Njësive Komunale përfshirë Junikun. Sipas vendimit të UNMIKU nr. 2005/21, MAPL bën përcaktimin e përbërjes territoriale për secilën Pilot Njësi Komunale. Kurse me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Kosovës (15 qershor 2008) dhe miratimin e ligjit për vetëqeverisjen lokale në komunat, Juniku certifikohet si Komunë (më datë 13 gusht 2008, sipas shkresës njoftuese nga MAPL me numër protokolli: 02-527) me të njëjtat kompetenca dhe përgjegjësi si Komunat tjera në Republikën e Kosovës, me zonat kadastrale Jasiq dhe Gjocaj.

Burimi: të dhënat historike nga komuna

HISTORY OF JUNIK

According to history Junik firstly was part of the Illyrian Dardania, then the Roman Empire, Byzantium and later under the Ottoman Empire. Archaeological artefacts discovered in tortuous explorations or coincidental findings, ancient settlement “Gradina” discovered at the mouth top of Gjeravica along with epigraphic material found in this settlement, and a myriad of other settlements of Junik, antique remnants found in the alluvial plain of Erenik, etc., prove that Junik has been an Illyrian settlement.

Archaeological evidences of VIII-X centuries prove that in those areas where the Slavic colonization failed to establish, a simple Albanian culture flourished called the Koman culture, the name of a village in the Dukagjini Valley.

During the period of advanced feudalism, Junik same as Gjakova and entire Kosovo, were included in the Serbian feudal state. At the time of the Kingdom of Yugoslavia, the Albanians were the overwhelming majority of the population in the area of Junik, but associated with massive population migrations, caused by historical, economic, political events, etc.

In the the beginning of the Ottoman Empire, according the Ottoman registers (“defter”), respectively of those of the Sanjak of Shkodra of 1485, Junik was a very large village and as Gjakova it was established before the advent of this rule. Until 26.IX.1462 Junik was governed by Leka III Dukagjini. At this time Junik, although it was just a village, is described as a bazaar center just as Gjakova. It was known as Lunik and also was the center of Alltun-Ilia Kaza (Qadaa, Qaza) with 52 homes in total.

During the XV-XVI centuries, the Serbian Orthodox Church, which accepted vassalage to the Sultan, gave a huge effort in serbification of Orthodox Albanians and converting catholic Albanians into orthodox. Islamisation of Junik's population tended to be a severe blow to the positions of the Serbian Orthodox Church, as the population of Junik and its surroundings were converted to Islam in exchange for allowing the existence of the church of Deçani. Thus, in 1570-1571, the first mosque was built in Junik, at the Çoku quarter, and named after that. Later another mosque was built in the Hoxha quarter, in the center of the village. In keeping their class privileges a part of Albanian nobility embraced Islam, too. By the end of XVI century the hinterland of Altun-ilu, Peja and Gjakova were included within the Sanjak of Dukagjini. This situation maintained even during the XVII century.


From 1945 until 1960 Junik was organized as a municipality. Political system changes resulted in the termination of then municipality of Junik in the wake of the restructuring of local government (districts abolished), during which Junik is incorporated within the municipality of Deçan. On July 22, 2005, an Administrative Order of UNMIK 2005/11 was signed on the establishment of five Pilot Municipal Units including Junik. According to UNMIK's decision no. 2005/21, MPLA defined the territorial composition of each Pilot Municipal Unit. Next, with the entry into force of the Constitution of Kosovo (15 June 2008) and adopting the Law on Local Self-governance of Municipalities, Junik becomes certified fully-fledged municipality (on August 13, 2008, according to the notifying paper of the MPLA with protocol number: 02-527) with same powers and responsibilities as other municipalities in the Republic of Kosovo, with Gjocaj and Jasiq cadastral zones.

Source: historical data from the municipality.

ADMINISTRATAT, STRUKTURA KOMUNALE DHE QEVERISJA

Juniku është një nga komunat më të reja të Kosovës, e certifikuar si komunë në gusht 2008. Zgjedhjet e Nëntorit 2009, shënuan zgjedhjet e para lokale të mbajtura ndonjëherë në këtë komunë. Administrata aktuale Komunale përbëhet nga zyra e Kryetarit dhe gjashtë drejtori komunale me sektorët e tyre dhe drejtorët e emëruar nga Kryetari (shih figurën 1).


Figura 1. Administrata komunale e Junikut



ADMINISTRATION, MUNICIPAL STRUCTURE AND GOVERNANCE

Junik is one of the newest municipalities in Kosovo, certified as a fully-fledged municipality in August 2008. The elections of November 2009 marked the first local elections ever held in this municipality. Current Municipal Administration consists of the Office of the Mayor and six municipal Departments and their sectors and directors appointed by the Mayor (see Figure 1).

Figure 1. Municipal administration of Junik



PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS

- * *Thesari i Kosovës - Zona e gjelbërt - Zonë industriale, shërbyese tregtare, agroindustriale me qendër kryesore Mitrovicën.*
- * Porti i Kosovës - zona e kaltërt - zonë administrative, arsimore, shërbyese, tregtare, agroindustriale, turistike me qendër kryesore Prishtinën
- * Kopshtet e Kosovës - zona e portokalltë - zonë kulturoturistike, agroindustriale dhe shërbyese tregtare. Qendrat kryesore: Prizreni, Peja.
- * Urat e Kosovës - zonat e verdha - zonë shërbyese, tregtare, agroindustriale e turistike me qendrat apo ura lidhëse me shtetet fqinje: Ferizaj, Gjilan, Gjakovë.

Juniku në Planin Hapësinor të Kosovës përfshihet në Zonën e Verdhë, ajo e “Urave të Kosovës”. Kjo hapësirë zë pjesën jugperëndimore të Kosovës dhe përbëhet nga komunat: Deçan, Rahovec, Malishevë dhe Gjakovën si qendër më e madhe komunale. Kjo zonë karakterizohet me vlera të mëdha të trashëgimisë natyrore e kulturore, të cilat paraqesin potencial për zhvillimin e shërbimit tregtar, agroindustrial, industrisë së lehtë dhe Turizmit rekreativ dhe atij kulturor.

Vizioni për Zonën e Verdhë: Urë e zhvillimit të lidhjeve të Kosovës me rajonin, rrjet funksional i qyteteve të fuqishme dhe fshatave dinamike, atraktive për të jetuar dhe punuar në to. Duke shfrytëzuar kapacitetet e infrastrukturës, pozitën gjeografike dhe pasuritë e shumta natyrore, kulturore dhe humane, të zhvillohet në një hapësirë të qëndrueshme ekonomike agroindustriale, tregtare, shërbyese dhe turistike.

Qëllimet e përgjithshme për Zonën e Verdhë relevante për Junikun:

- Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetesës së qytetarëve, punësimi, barazisë sociale,
- Mbështetje ZHEL për ZHEK – shfrytëzimi i përparësive konkurruese,
- Zhvillimi i lidhjeve efikase brenda urbane, ndër - urbane me hapësirat e tjera dhe më gjerë në rajon përmes rrjetit të zhvilluar të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, ajrore dhe TIK),
- Përkrahja zhvillimeve për arsim bashkëkohor e përkrahës të kërkesave të tregut,
- Ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore, turizmit kulturor e rekreativ,
- Zhvillim të lidhjeve tregtare e shërbyese ndërkufitare me Shqipërinë,
- Aeroporti civil i Gjakovës si mundësi për zhvillim ekonomik,
- Zhvillimi i shërbimeve tregtare, agro-industriale, turistike, me intensifikim të politikave për mbrojtje dhe rimëkëmbje të mjedisi Juniku dhe zonat me interes për Kosovën: Sipas PHK në “Hapësirën e Verdhë” si zona me interes të veçantë konsiderohen: Kullat e Dukagjinit, Kalimet kufitare (Prush e Qafë Morinë); Aeroporti i Gjakovës; Liqeni akumulues - Radoniqi; Çarshia e Madhe - Gjakovë; Manastiri i Deçanit.

SPATIAL PLAN OF KOSOVO

- * Treasure of Kosovo - Green Zone - Industrial Zone, commercial services, agroindustrial zone mainly based in Mitrovica.
- * Port of Kosovo - the blue zone - administrative, educational, service, commercial, agroindustrial, touristic zone with Pristina home based.
- * Gardens of Kosovo - the orange zone - cultural, touristic, agro-industrial and commercial service zone. Main Centres: Prizren, Peja.
- * Bridges of Kosovo - the yellow zone - service, commercial, agro-industrial and touristic zone, with the centers or connecting bridges with neighboring states: Ferizaj, Gjilan, and Gjakova.

In Kosovo Spatial Plan Junik is included in the Yellow Zone, on the “Bridges of Kosovo.” This zone occupies the southwestern part of Kosovo and consisted with the municipalities of Deçan, Rahovec, Malisheva and Gjakova - as the largest municipal center. This area is characterized by large amounts of natural and cultural heritage, which present the potential for development of tradeing services, agro-industry, light industry and recreational and cultural tourism.


Vision for the Yellow Zone: A bridge of developing relations of Kosovo with the region, a functional network of cities and villages, powerful dynamic, attractive place to live and work in them. By utilizing the infrastructure capacities, geographic position and abundant natural, cultural and human wealth in developing a sustainable economic agro-industrial, commercial, service and touristic zone.

The general goals of Yellow Zone relevant to Junik are:


- Network development of settlements, with the governance and public services in favor of the citizens, with increased quality of life for citizens, employment and social equality,
- Support LED for MED - the use of competitive advantages,
- The development of effective links within urban, inter- urban areas and the wider in the region through a network of developed infrastructure (road, rail, air and TK),
- Support for the development of contemporay and market requirement-based education,
- Preservation and development of cultural heritage, recreational and cultural tourism,
- Development of cross-broder commercial and service communication with the Republic of Albania,
- Civil airfield of Gjakova as an opportunity for economic development,
- The development of commercial, agro-industrial and touristic services, increase of the policies for environmental protection and revival of Junik's environment and other zones of interest for Kosovo: According to SPK, in the “Yellow Zone” as zones of special interest are considered: Kullas (house towers) of Dukagjin, Border crossings (Prush and Qafë Morinë); Gjakova Airfield, Accumulative lake - Radoniq, Grand Bazaar - Gjakova and Deçan Monastery.

► Kosova e ndarë skematikisht në zona sipas karakteristikave dhe potencialeve të ngjashme zhvillimore

Kosova divided in areas, by similar development characteristics and potentials



► Strategjia e Zhvillimit Hapësinor
► Spatial Development Strategy



STRATEGJIA ZHVILLIMORE LOKALE 2009

Ky dokument ka të bëjë me një analizë të përgjithshme mbi zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen viset rurale.. Hartimi i kësaj strategjie ka të bëjë me bashkimin e sektorit publik dhe të atij privat, për të bërë analizë të përbashkëta për të zhvilluar së bashku veprimet praktike me pikëpamjet afatgjate.

Synimet strategjike për Junikun janë:

1. Aplikimi i teknologjive të reja në prodhimtarinë bujqësore,
2. Zhvillimi i turizmit dhe promovimi i trashëgimisë kulturore,
3. Menaxhimi i qëndrueshëm i Mjedisit,
4. Grumbullimi dhe përpunimi i prodhimeve bujqësore – pyjore,
5. Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës rurale,
6. Vëmendje më e madhe për të rinjtë.

Zbatimi i Strategjisë Zhvillimore Lokale , akterëve dhe institucioneve Lokale u siguron përmirësimin e aftësive për të vlerësuar mjedisin e tyre që të marrin veprime të përbashkëta , lidhje midis sektorëve, shtimin maksimal të vlerës dhe se fundi lidhet me viset tjera në rajon dhe me tere boten.

PLANET HAPËSINORE NE KOMUNAT FQINJE

Pozita gjeografike e Junikut, karakteristikat topografike dhe veçoritë natyrore përveç që e lidhin komunën e Junikut me ato fqinje, paraqesin njëherit edhe fusha me interes të përbashkët dhe mundësi për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar.

Duke marrë parasysh që komunat fqinje si ajo Deçanit dhe Gjakovës janë një hap më përpara në fushën e planifikimit hapësinor (komuna e Deçanit ka të miratuar PZHK dhe PZHU dhe ajo e Gjakovës është më e kompletuar sa i përket dokumenteve të planifikimit-ka të miratuar PZHK, PZHU dhe 9 PRRU), komuna e Junikut në fillim të procesit të hartimit të PZHK ka konsultuar dokumentet e planifikimit hapësinor të këtyre dy komunave. Qëllimi i njohjes me këto dokumente ka qenë që të identifikon projektet nga PZHK e Deçanit dhe Gjakovës të cilat kanë ndërlidhje apo dhe janë në interes të përbashkët me zhvillimin hapësinor të ardhshëm të komunës së Junikut.

LOCAL DEVELOPMENT STRATEGY

This paper deals with a general analysis on solving problems rural areas are facing. This strategy has to do with bringing together public and private sector for joint analysis in developing practical actions in long-term view.

Strategic goals of Junik are:

1. Application of new technologies in agricultural production.
2. Development of tourism and the promotion of cultural heritage
3. Sustainable Environmental Management
4. Collection and processing of agricultural and forest products.
5. Improvement and development of rural infrastructure
6. Greater attention to youth.

Implementation of the Local Development Strategy provides stakeholders and local institutions with skills to evaluate their environment for joint action, links between sectors, maximum increase of the value and finally, connecting with other areas in the region and to whole world.

SPATIAL PLANNING IN NEIGHBOURING MUNICIPALITIES

The geographical position of Junik, topographical and natural features except linking Junik with neighboring municipalities, at the same time represent the common interest and opportunities for inter and cross-border cooperation.

Given that neighboring municipalities such as Deçan and Gjakova are a step forward in the field of spatial planning (Deçan municipality has approved MDP and UDP and the one of Gjakova is the most completed in terms of planning documents – it has adopted the MDP, UDP and 9 URP's); the Municipality of Junik in the early stage of drafting the MDP has consulted spatial planning documents of the two municipalities. The purpose of consulting of these documents was to identify the projects in MDP's of Deçan and Gjakova which are in conjunction or in common interest with future spatial development of the Municipality of Junik.



GJENDJA FIZIKO- GJEOGRAFIKE

Lokacioni - Pozita Gjeografike

Pozita: Juniku ndodhet në pjesën perëndimore të Kosovës, pranë bjeshkëve të Nemuna. Ka një territor me sipërfaqe prej 77.77 km² dhe shtrihet në një gjerësi gjeografike prej 42,22° dhe në gjatësi gjeografike prej 20,26°. Ka një pozicion gjeografik të përshtatshëm sepse shtrihet deri në veri-perëndim të fushës së Dukagjinit, përballë grykës së lumit Erenik, i cili buron nga liqejt e Gjeravicës dhe dredhon nëpër luginat e Alpeve Shqiptare.

Territori i Komunës së Junikut shtrihet deri në veri-perëndim të fushës së Dukagjinit, dhe kufizohet nga komuna e Deçanit, komuna e Gjakovës, kufiri Shqiptar dhe kufiri i Malit të Zi. Distanca e Junikut nga Peja është 25 km, nga Gjakova 20 km dhe kalon nëpërmjet fshatit Batushë, ndërsa nga magjistralja Pejë - Gjakovë është 5,5 km.

Karakteristikat gjeografike

Topografia: Komuna e Junikut ka pozitë të përshtatshme gjeografike para grykës piktoreske të lumit Erenik. Lartësia mbidetare e Junikut shkon nga 450 deri në 600 metra mbi nivelin e detit. Vet qyteza e Junikut gjendet në një lartësi mbidetare prej 593m. Maja më e lartë është Gjeravica, me një lartësi mbidetare prej 2656 m e cila është gjithashtu edhe pika më e lartë në Kosovë e Alpeve Shqiptare.

Veçoritë natyrore: Juniku ka lloje të ndryshme peisazhesh, nga ai hidrografik (lumenjtë Erenik dhe Travë), peisazhe fushore (fusha e Junikut) dhe peisazhe kodrinore apo malore (Gjeravica, Moronica). Me datën 28.08.2008 Kuvendi Komunal i Junikut ka shpallur Moronicën “zonë të veçantë të Komunës së Junikut” . Kjo zone mendohet të jetë “parku i ardhshëm i qytezës(..) që do të jetë si urë lidhëse në mes të parkut etnografik dhe parkut nacional të Bjeshkëve të Nemuna”. Në tërësinë e tij, Juniku paraqitet si një entitet që ka qenë, është dhe do të jetë i lidhur ngushtë me natyrën.

Kushtet klimatike: Juniku ka klimë kontinentale por me disa tipare mesdhetare. Kjo klimë është e përshtatshme për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore. Mesatarja e temperaturës është 21C në verë dhe -11C në dimër. Sasia mesatare e të reshurave është afër 670 mm, kurse në sezonin e vegjetacionit (prej muajit të IV-IX) afër 330 mm.

Lumenjtë dhe sipërfaqet ujore: Lumi Erenik është më i madhi dhe më i rëndësishmi i rajonit, i cili shërben gjithashtu si burim uji edhe për ujitjen e fushës së Junikut. Ereniku buron nga liqejt e Gjeravicës. Ujërat që rrjedhin përkatësisht vijnë nga kurorat e maleve, nga gropa e Erenikut dhe nga Bjeshkët e Nemuna, formojnë rrjedhat sipërfaqësore të ujërave. Nëse menaxhohet mire dhe nuk ka keqpërdorime të ujit, ka sasi të mjaftueshme edhe për ujitje dhe ujë të pijes.

PHYSICAL AND GEOGRAPHICAL POSITION

Location - Geographical Position

Position: Junik is located in the western part of Kosovo, near the Bjeshkëve të Nemuna (Cursed Mountains). It has a surface area of 77.77 km² and lies at latitude of 42.22 ° and longitude of 20.26 °. It holds a convenient geographic position since extends to the north-west of Dukagjini area, vis-a-vis the Gorge of Erenik River, which stems from Gjeravica Lakes and wandering through the Albanian Alps.

Territory of Municipality Junik stretches to the north-west of the Dukagjini area and bounds with the Municipality of Deçan, Municipality of Gjakova, Albanian border and with the border of Montenegro. The distance of Junik from Peja is 25 km, from Gjakova 20 km and passes through the village Batusha, while the highway Peja-Gjakova is 5.5 km.

Geography

Topography: The Municipality of Junik has very convenient geographical position with a scenic river gorge of Erenik River. Junik elevates in a height from 450 to 600 meters above sea level. Junik own is located in an altitude of 593 m. Highest peak is Gjeravica, with an altitude of 2.656 m which is also the highest peak of Albanian Alps in Kosovo.

Natural features: Junik possesses different types of landscapes, from the hydrographical (Erenik and Trave rivers), field landscapes (Junik field) and those hilly or mountainous landscapes (Gjeravica, Moronica). On 28.08.2008 Municipality of Junik has decalred Moronica a “special zone of the Municipality of Junik.” This area is thought to be “the next town park (..) and that would kind of bridge the Ethnographic Park and National Park Bjeshkët e Nemuna.” In its entirety Junik is presented as an entity that has been, is and will be closely connected with nature.

Climate conditions: Junik has a continental climate with some Mediterranean traits. This climate is suitable for cultivation of different crops. The average temperature is 21C in summer and -11C in winter. The average amount of precipitation is about 670 mm and in the vegetation season (months IV-IX) near 330 mm.

Rivers and water surfaces: Erenik River is the largest and the most important of the region, which also serves as water source for irrigation of Junik Field. Ereniku stems from Gjeravica Lakes. Waters that flow, respectively that come from mountain tops, from the Erenik sump and Bjeshkët e Nemuna, generate surface water flows. If managed well and if no misuse of water, there is sufficient water for irrigation and drinking.

Përbërja e tokës: Nga sipërfaqja prej 77,769.931 ha sa ka komuna e Junikut, afërsisht 4.439 ha (57.08%) janë tokë bujqësore. Livadhet e kullotat zënë një sipërfaqe prej rreth 2000 ha (45.05%) nga sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore si dhe pyjet që zënë mbi 3.029 ha (38.95%) që paraqesin potencial për zhvillim. Në zonën urbane të Junikut dominon tokë relativisht e thellë e përshtatshme për prodhime bujqësore. Ndërsa ne pjesët tjera jashtë zonës urbane dominon tokë e cekët e përshtatshme për kullosa dhe zhvillim të pylltarisë.

Flora dhe fauna: Afërsia me natyrën ka bërë të mundur që Juniku të jetë i pasur në planin e biodiversitetit. Biodiversiteti reflekton shumëllojshmërinë e qenieve të gjalla varësisht së në cilën zonë zhvillohen. Ky concept përmbledh gjithashtu laramanin brenda llojit, ndërmjet llojeve dhe ndërmjet ekosistemeve (elaborim më i gjerë është bërë në kapitullin e biodiversitetit).

Konkluzion: Juniku si komunë relativisht e vogël ka një pozitë të volitshme ndërkufitare dhe lidhje të shkurta me qytetet përreth Deçan, Pejë, Gjakovë . Pozita e volitshme gjeografike e Junikut paraqet një mundësi për zhvillim ekonomik të komunës dhe bashkëpunim ndërkufitar. Gjeomorfologjia e Junikut si dhe veçoritë natyrore të komunës së Junikut paraqesin vlera dhe potencial të madh për zhvillim.

GJENDJA SOCIALE-EKONOMIKE

Shënim: Në mungesë të regjistrimit të përgjithshëm valid në Kosovë, gjatë hartimit të PZHK për komunën e Junikut të dhënat për numrin e banorëve janë bazuar në anketimin e bërë në terren¹, të dhënat nga Enti Statistikor, të dhënat nga Ligji mbi financat e pushtetit lokal (LFPL) si dhe vlerësimet të bëra pas luftës të vitit 1999 nga organizata dhe institucione ndërkombëtare dhe vendore të cilat bazohen në anketime dhe hulumtime në terren. Regjistrimi i fundit valid në Kosovë është ai i bërë në vitin 1981. Të dhënat statistikore të mbledhura dhe të publikuara nga ky Ent deri në vitin 1988 konsiderohen të besueshme. Të dhënat për periudhën 1990-1999 janë të mangëta dhe në pjesë të madhe nuk pasqyrojnë realisht situatën në Kosovë gjatë kësaj periudhe, kështu që si të tilla duhen të trajtohen me maturi meqë regjistrimi u bojkotua nga popullata shqiptare.

Profili demografik

Popullsia: Sipas statistikave të vitit 1981 dhe disa shënimeve të pasluftës kur Juniku në vitin 2005 u themelua si Pilot Njësi Komunale numëronte rreth 12,500 banorët, përfshire Gjocaj, Jasiq edhe tri zona tjera kadastrale Voksh, Sllup dhe Rastavic. Ndërsa në vitin 2008 me aprovimin e kushtetutës dhe miratimit të ligjit për kufijtë administrativë Juniku bëhet komunë me dy zona kadastrale: Junikut dhe zona kadastrale Gjocaj e Jasiq dhe vlerësohet të ketë 9600 banorë me diasporën (sipas LFPL).

Soil Composition: From the total area of 77.769,931 ha that the municipality of Junik bears, approximately 4,439 ha (57.08%) are agricultural land. Meadows and pastures occupy a territory of about 2,000 ha (45.05%) of the total surface of agricultural land and forests that occupy over 3,029 ha (38.95%) that present potential for development. The urban area of Junik is dominated with the relatively deep soil suitable for agricultural products. While in other parts outside the urban area dominates thin soil suitable for grazing and forestry development.

Flora and fauna: The proximity to nature made Junik being abundant in terms of biodiversity. Biodiversity reflects the variety of living beings depending from territory they live. This concept also encompasses the diversity within species, among species and between ecosystems (extended elaboration in the chapter on biodiversity).

Conclusion: Junik is a relatively small municipality but with good crossboundary position and short linkages with neighbour municipalities Deçan, Peja and Gjakova. Good geographical position is an opportunity for economic development and crossborder cooperation. Natural and cultural features present a potential for future developments.

SOCIAL AND ECONOMIC SITUATION

Note: In the absence of valid general census in Kosovo, during the development of the MDP for the Municipality of Junik the data on the number of residents are based on the field-based survey, data from the Statistical Office, data from the Law on Local Government Finance (LLGF) and assessments made after the war of 1999 by international organizations and local institutions which are based on field surveys and research. The last valid census in Kosovo is from the year 1981. Statistical data collected and published until 1988 by this Office are considered reliable. The data for 1990-1999 are incomplete and in large portion do not realistically reflect the situation in Kosovo during this period, so as such should be handled with caution since the census was boycotted by the Albanian population.

Demographic profile

Population: According to statistics from 1981 and some postwar records, Junik after establishing as the Pilot Municipal Unit in 2005, numbered about 12.500 inhabitants, including Gjocaj and Jasiq and three other cadastral units such are Voksh, Sllup and Rastavicë. While in 2008 with the approval of the Constitution and the adoption of the law on municipal boundaries Junik becomes fully-fledged municipality with two cadastral zones: Gjocaj and Jasiq, and is estimated to have 9,600 inhabitants together with diaspora (according to LLGF).

Tabela 1: Popullsia e Junikut gjatë viteve, (ESK,2009)

Nr. vend.	Vendbanimet	Popullsia												2008
		1948						1991						
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
1	Gjocaj	210	180	138	161	215	306	34	24	18	25	24	40	-
2	Jasiq	331	376	190	231	295	306	27	56	24	29	30	33	2
3	Junik	2,391	2,439	3,024	3,445	4,553	5,450	378	385	462	460	541	630	622
Juniku gjithësej		2832	2995	3,352	3857	5063	6102	439	465	504	514	595	763	624

*Popullsia kështu si e raportuar në fillim të vitit 2008

Të dhënat e fundit zyrtare nga ESK (2009) nga anketimi "Popullsia, ekonomitë familjare sipas vendbanimeve dhe organizimi territorial i Kosovës deri në vitin 2008, tregojnë se Juniku si vendbanim ka 624 ekonomi familjare, 5423 anëtarë rezident, 1427 objekte ndërtimore, kurse fshatrat Jasiq - Gjocaj kanë 2 ekonomi familjare me gjithsej 7 anëtarë dhe 38 objekte ndërtimore.

Nga ana tjetër, të dhënat e marra nga anketimi në terren për nevojat e PZHK, tregojnë se në Junik ka 741 ekonomi familjare me gjithsej 7138 banorë përfshi edhe diasporën. Mesatarja ekonomive familjare është 6 anëtarë.

Në tabelën e mëposhtme janë të dhënat mbi popullsinë sipas moshës dhe gjinisë. Më se 50% e popullsisë janë nën moshën 26 vjeçare. Raporti gjinor është pothuasje i balancuar (F:M=50.26%: 49.74%). Popullsia i përket etnisë shqiptare.

Tabela 2: Popullsia sipas moshës dhe gjinisë nga analizat në terren (përfshirë popullsinë në diasporë)

Popullsia sipas moshës dhe gjinisë													
1-7		8-18		19-25		26-40		41-64		>65			
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
7.06%	6.54%	9.92%	10.46%	8.48%	7.71%	12.70%	11.67%	8.60%	8.95%	2.98%	4.93%		
13.60%		20.38%		16.19%		24.37%		17.55%		7.91%			

Trendi dhe prognoza demografike: Popullsia e Junikut paraqitet mjaft "delikate" ndaj ndryshimeve ekonomike sado të vogla qofshin ato, apo edhe nga faktorë të jashtëm të cilët influencojnë zhvillimet demografike dhe ekonomike në qytezë. Por, pavarësisht mungesës së informacioneve zyrtare, mund të themi se Juniku është një vendbanim në zhvillim dhe me tendencë për t'u ndërtuar, prandaj është i domosdoshëm kontrolli dhe udhëzimi për këtë zhvillim. Parashikimi demografik është bazuar në llogaritjen e shkallës së shtimit popullsisë në nivelin të Kosovës (e cila sipas statistikave të nxjerra nga Enti Statistikor është rreth 1.4%). Sipas këtij trendi, Juniku pritet që në vitin 2023+ të ketë rreth 11 000 banorë (nëse mirret e dhëna zyrtare prej 9 600 banorëve përfshi diasporën). Duke ditur që të dhënat në terren dhe ato nga ESK tregojnë një situatë ndryshe zyrtare, numri i banorëve rezident në Junik (sipas të dhënave të ESK) deri në 2023 pritet të jetë rreth 6 600 banorë (pra pa diasporën), respektivisht rreth 8 700 banorë me diasporën (llogaritur me të dhënat nga anketimi për PZHK).

Junik

No.	Settlements	Population						Households						
		1948		1991		2008		1948		1991		2008		
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
1	Gjocaj	210	180	138	161	215	306	34	24	18	25	24	40	-
2	Jasiq	331	376	190	231	295	306	27	56	24	29	30	33	2
3	Junik	2,391	2,439	3,024	3,445	4,553	5,450	378	385	462	460	541	630	622
Juniku in total		2832	2995	3,352	3,857	5063	6102	439	465	504	514	595	763	624

*Junik municipality was formalized in late 2008

The latest official data from SOK (2009) extracted from the survey "Population, households according settlements and territorial organization of Kosovo until 2008", show that Junik as a township has 624 households, resident members 5,423 resident inhabitants, 1,427 construction buildings, while Jasiq – Gjocaj villages have 2 households with a total of 7 members and 38 construction buildings.

On the other, the data obtained from the field survey for the MDP show that there are 741 households in a total of 7,138 inhabitants including Diaspora. The average household has 6 members.

In the table below are data on population by age and gender. Almost 50% of the population is under the age of 26. Gender ratio is almost balanced (F: M = 50.26%: 49.74%). The ethnicity of population is Albanian.

Table 2: Population by age and gender from field surveys (including the population in the Diaspora)

Population by age and gender													
1-7		8-18		19-25		26-40		41-64		>65			
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
7.06%	6.54%	9.92%	10.46%	8.48%	7.71%	12.70%	11.67%	8.60%	8.95%	2.98%	4.93%		
13.60%		20.38%		16.19%		24.37%		17.55%		7.91%			

Trend and demographic forecast: Population of Junik appears very "sensitive" to economic changes, no matter how small those appear, or from external factors that influence the demographic and economic developments in town. However, despite the lack of official information we can emphasize that Junik is a town in development and the tendency of being built: therefore it is necessary a regulation and direction for such development. Demographic forecast is based on calculating the rate of population increase in Kosovo level (which according to statistics issued by the Statistical Office is about 1.4%). According to this trend, Junik is expected that in 2023 + to have around 11, 000 inhabitants (if considered the official data of 9,600 inhabitants including the diaspora). Given that the data of the field survey and those of SOK show different situation, the number of people resident in Junik (according to SOK) by 2023 is expected to be about 6,600 inhabitants (i.e. without the diaspora), respectively, about 8,700 residents with the Diaspora (calculated from data collected from the survey for MDP).

Gjendja sociale

Punësimi dhe papunësia: Ashtu sikur në tërë Kosovën, shkalla e papunësisë edhe në komunën e Junikut është e lartë dhe paraqet një aspekt shqetësues. Nga të dhënat e marra në terren nga anketimi del se nga popullsia aktive për pune (të moshës 19-64 vjeç) vetëm 22.76% e tyre janë të punësuar respektivisht të papunë janë 77.24% e popullsisë aktive. Nga 22.76% e të punësuarve, 4.03% janë femra ndërsa 18.73% meshkuj që do të thotë se raporti i punësimit sipas gjinisë është gati F:M=1:5.

Deri sa ishin në funksion kapacitetet prodhuese, numri i të punësuarve ka qenë shumë më i madh e sidomos në Fabrikën e Konfeksionit në Junik ku kanë punuar më tepër se 230 punëtorë. Në mungesë të punësimit në këto kapacitete një numër i të punësuarve kanë gjetur mundësinë e punësimit në bizneset e vogla private. Përveç mosfunksionimit të kapaciteteve prodhuese, faktorë tjerë që kanë ndikuar më së shumti në rritjen e shkallës së papunësisë janë:

- Procesi i privatizimit (Pronat e Ndërmarrjes Shoqërore Ereniku)
- Kushtet e vështira gjeografike dhe ekonomike
- Mungesa e investimeve në infrastrukturë
- Mungesa e investimeve në sektorin e Bujqësisë
- Mungesa e politikave të nivelit qendror në krijimin e vendeve të reja të punës

Të dhënat për vitin 2009 nga hulumtimi i GAP, tregojnë se numri i të punësuarve në sektorin publik është 141. Krahasuar me vitin 2008, numri i shërbyesve civil është rritur për 23 persona.

Të ardhurat: Të ardhurat kryesore vijnë nga përpunimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale. Mirëpo duke pasur parasysh numrin e madh të Junikasve që gjenden jashtë vendit (përgjithësisht në Zvicër dhe Gjermani), konsiderohet që ndihma ekonomike që vjen nga jashtë përbën gjithashtu një burim të ardhurash të rëndësishme për komunën. Sipas anketimit, rezultatet mbi të ardhurat mesatare familjare janë si vijon:

Tabela 4: Të ardhurat mesatare sipas anketimit në terren

Të ardhurat	<201 €	%	201 €	%	>201 €	%	% pa përgjigje
Nr.familjeve	248	33.47%	175	23.61%	165	22.26%	20.64%

Varfëria dhe asistenca sociale: Sipas të dhënave nga qendra për unë sociale të Komunës së Junikut, gjithsej janë 685 individ apo 12.6% e popullsisë rezidente në Junik jeton në varfëri. Kjo vlerë tregon se kemi të bëjmë me shkallë të mesme të varfërisë meqë % e popullsisë që marrin asistencë sociale është në vlerat 4-22%. Rritjes së shkallës së varfërisë i ka kontribuar: shkalla e lartë e papunësisë, shkatërrimi masiv gjatë luftës sidomos për vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj.

Strehimi: Komuna Junikut nuk ka probleme të pastrehëve dhe e gjithë popullata kanë strehim adekuat, duke marrë parasysh edhe atë se Lagjja Agim Ramadani është duke u shfrytëzuar në një formë si banim social dhe strehim për banorët e zhvendosur nga fshatrat Jasiq dhe Gjocaj.

Social situation

Employment and unemployment: As generally in Kosovo, the unemployment rate in the municipality of Junik is high and presents a point of concern. From the data obtained from the field survey it results that only 22.76% of the active working population (age 19-64 years) are employed; respectively 77.24% of active population is unemployed. From 22.76% of the employed 4.03% are female and 18.73% male, which means that the ratio of employment by gender is almost F: M = 1:5.

While the production capacities were running, the number of the employed had been much higher, especially in the Confection factory in Junik where more than 230 people were employed. In the absence of employment in such capacity a number of employees found employment opportunities in small private businesses. Besides the failure of manufacturing capacity, other factors that have affected most to the increase of the unemployment rate are:

- The privatisation process (Ereniku Social Enterprise Holdings)
- Difficult geographic and economic conditions
- The lack of investments in infrastructure
- The lack of investments in the agricultural sector
- The absence of policies of central authorities in creation of new work.

The data for 2009 from the research project of GAP indicate that the number of employees in the public sector is 141. Compared with 2008, the number of civil servants has increased by 23 persons.

Incomes: Majority of income comes from the processing and market of agricultural and livestock products. But given that the large number of the population of Junik lives abroad (generally in Switzerland and Germany), it is considered that economic assistance (remittances) coming from abroad is also an important source of revenues for the municipality. According to survey the average household incomes are as follows:

Table 4: Average income by field survey

Incomes	<201 €	%	201 €	%	>201 €	%	No response
No. of households	248	33.47%	175	23.61%	165	22.26%	20.64%

Poverty and social assistance: According to datas from the Center for Social Welfare of the Municipality of Junik, there are 685 individuals or 12.6% of resident population in Junik living in poverty. This rate indicates that we are dealing with medium level of poverty since the percentage of population in receiving social assistance is 4.22%. To the increase of poverty rate has contributed the: high unemployment rate, massive destruction during the war, especially in Jasiq and Gjocaj settlements.

Housing: Junik municipality has no issues of homeless and the entire population has an adequate housing, taking into account that Agim Ramadani quarter is being used as a social housing and housing for displaced persons from Gjocaj and Jasiq villages.

Migrimi: Në mungesë të regjistrimit të popullsisë, nuk dihet numri i saktë zyrtar i familjeve që jetojnë në diasporë. Por sipas anketimit të bërë në terren për nevojat e këtij plani, del se 25% e popullsisë së Junikut jeton jashtë Kosovës dhe interesimi për të migruar jashtë në kërkim të kushteve më të mira për jetë dhe gjetjen e mundësive për punësim është ende prezent. Kjo sipas anketimit është shprehur në gati 12% të familjeve të cilat kanë deklaruar se kanë të interesuar për të migruar jashtë vendit, e shprehur sidomos tek rinia mashkullore.

Organizimi i shoqërisë civile: Shoqëria civile në Komunën e Junikut nuk është e organizuar dhe si e tillë nuk është edhe shumë aktive. Ndoshta një gjendje e tillë ndodh për shkak se kjo Juniku është komunë e re dhe se deri më tani nuk ka pasur kapacitete të zhvillohet ky sektor me rëndësi për shoqërinë.

Infrastruktura dhe shërbimet sociale

Gjendja në shëndetësi dhe shërbimet shëndetësore: Shërbimet shëndetësore parësore ofrohen nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), e cila gjendet në qytetin e Junikut dhe numëron gjithsej 22 punëtorë të sistemuar në dy turrne punësimi. Nga ky numër, katër (4) janë mjekë, dy (2) stomatologë dhe pjesa tjetër, staf i mesëm dhe staf ndihmës. QKMF ofron të gjitha shërbimet e kujdesit parësor shëndetësorë si dhe shërbime Oftalmologjike dhe Stomatologjike.

Qasja dhe gravitimi i banorëve deri tek QKMF është e lehtë, dhe madje shfrytëzohet edhe nga baorët e disa fshatrave të Deçanit dhe Gjakovës. Duke e marrë parasysh kriterin 3 se për 2000 banorë nevojitet 1 mjek dhe 2 motra medicinale, QKMF në Junik e plotëson këtë kriter.

Aktualisht hapësira ekzistuese në kuadër të QKMF nuk është e mjaftueshme, mirëpo me realizimin e projektit të QKMF së re (i cili pritet të realizohet më 2010), shërbimet shëndetësore do të përmirësohen dukshëm si dhe do të ketë kapacitete të mjaftueshme për ofrimin e këtyre shërbimeve. Kuadri aktual mjekësor i plotëson nevojat për shërbimet e nevojshme për dy ndërrime, mirëpo me ndërtimin e objektit të ri synohet të ketë 24 orë shërbim (varësisht nëse lejohet rritja e numrit të punësuarve nga organi përgjegjës i qeverisë qendrore). Shërbimet dytësore ofrohen nga Spitalet rajonale të Gjakovës dhe Pejës.

Gjendja në arsim dhe shërbimet arsimore:

Procesi edukativo-arsimor në Komunën e Junikut zhvillohet në nivelet: parafillor përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta, fillor (klasat 1-5), shkolla e mesme e ulët (6-9) dhe arsimi i mesëm i lartë (shih tabelën 5).

Tabela 5: Numri nivelet e arsimit në procesin edukativo-arsimor

Nr.	Niveli shkollor	Nr. nxënësve	Mësimdhënës	Administrata	Pastrues-roje	Totali
1.	Parafillor	61	1			1
2.	Fillor dhe i mesëm i ulët	725	37	2	5	44
3.	Arsim i mesëm i lartë	251	13	1	3	17
4.	P.me nevoja të vecanta	6	1			1
	Totali	1037	52	3	8	63

Migration: In the absence of a census, the exact number of families living in diaspora is unknown. But according to surveys done in the field for the purpose of this plan indicates that 25% of the population of Junik lives outside Kosovo and the interest for migration abroad in search of better conditions for life and finding job opportunities is still present. According to the survey nearly 12% of households stated that they are interested to migrate abroad, and widely expressed particularly from the male youth.

The organization of civil society: Civil society in the municipality of Junik is not organized and as such is not very active. Probably such situation occurs because Junik is newly established municipality and so far has not had the capacity to develop this important sector of society.

Social infrastructure and social services

Situation in health and health services: Primary health care services are provided by the Main Family Health Care Centre (MFHCC), which is located in the town of Junik and in total counts 22 workers arranged in two shifts. Of these, four (4) are physicians, two (2) dentists and the rest are the secondary and support staff. MFHCC offers all primary health care services as well as ophthalmologic and dental services.

Access and gravitation of residents to the MFHCC is easy and used even by residents of several villages of Deçan and Gjakova. Given the criteria that in 2,000 people there should be 1 physician and 2 nurses, MFHCC in Junik meets this requirement.

Currently the existing spaces within the MFHCC are insufficient, but with the implementation of the project of the new MFHCC (which is expected to be complete in 2010), health services will be improved significantly and sufficient capacity for the provision of such services. Health cadre meets the current needs for medical services for two shifts, but with the construction of new building it aims in providing 24-hour service (depending on whether allowed the increase of the number of employees by the responsible body of central government). Secondary services are provided in Regional hospitals of Gjakova and Peja.

Situation in education and education services:

Education process in the municipality of Junik is organized in: preschool, including children with special needs, primary education (grades 1-5), lower secondary education (6-9) and upper secondary education (see Table 5).

Table 5: Number, level of education in the educational process

No	Level of education	No of students	Teachers	Administration	Cleaner-Guard	Total
1.	Pre-school	61	1			1
2.	Primary and lower secondary	725	37	2	5	44
3.	Upper secondary education	251	13	1	3	17
4.	Persons w. special needs	6	1			1
	Total	1037	52	3	8	63

Nëse shikohet kriteri i bankës botërore në shkollën fillore dhe të mesme të ulët ky kriter është respektuar dhe përkon me numrin e nxënësve dhe të punëtorëve të arsimit (21.3 nxënës 1 mësimdhënës, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë numri i punëtorëve të arsimit është më i madh). Ndërtimi i objektit të ri të shkollës se mesme me kapacitete të mjaftueshme dhe kushte bashkëkohore ka përmirësuar kushtet e mësimdhënies në shkollën fillore sepse janë liruar ambientet e shkollës fillore ekzistuese nga nxënësit e shkollës së mesme dhe ata munden tani të zhvillojnë mësimin në dy ndërrime e jo tri siç ka qenë më parë. Megjithatë, këto shkolla ende nuk kanë salla sporti, e kur dihet se komuna nuk ka edhe qendër sportive. Aritja në shkollë, për diku rreth 90% të nxënësve është deri diku e lehtë. Largësia më e madhe është në diametër prej 3 km dhe për këtë komuna nuk ka obligim ligjor të siguroj transport. Qasje pak më të vështirë kanë vetëm nxënësit e lagjes Agim Ramadani dhe ata që vijnë nga zonat rurale edhe nga fshatrat e komunave fqinje.

Juniku nuk ka institucione parashkollore të cilat sigurojnë shërbimet e çerdheve dhe kopshteve. Shërbimi i arsimit parashkollor është i organizuar në hapësirat e shkollës fillore, por kjo nuk do të thotë që komuna nuk ka nevojë për të pasur institucione të tilla (sidomos çerdhe/kopshte).

Mundësitë për edukimin e personave me nevoja të veçanta fizike ekzistojnë, mirëpo familjarët në shumicën e rasteve nuk i dërgojnë fëmijët në paralele për persona me nevoja të veçanta.

Shënime për nivelin e analfabetizmit nuk ka meqë nuk janë bërë ende statistika për shkollën e analfabetizmit.

Objektet e religjionit: Në Junik gjinden 12 objekte kulti, të cilat janë të shpërndara në gjithë territorin e tij. Ndër to bëjnë pjesë edhe dy xhami, prej të cilave Xhamia më e vjetër është ajo që gjendet në lagjen Çoku e cila daton prej vitit 1570. Ndërsa Xhamia tjetër është ajo e lagjes "Hoxhaj" dhe quhet "Xhamia e Qendrës". Aktualisht në Junik ekziston edhe një teqe e sapo ndërtuar e cila u dedikohet besimtarëve halvetinj. Në përgjithësi, këto objekte plotësojnë nevojat e banorëve dhe poashtu paraqesin dhe objekte me vlera kulturo-historike.

Objektet dhe hapësirat publike, si dhe hapësirat për sport, kulturë dhe zbavitje: Në territorin e Junikut vërehet një mungesë e madhe e institucioneve për kulturë (muze, teatër, kinema, bibliotekë), institucione dhe hapësira për sport e rekreacion, si dhe hapësirave publike (parqe, sheshe etj). Aktualisht nevojat e banorëve për sport dhe rekreacion i përmbush vetëm Hapësira për sport dhe rekreacion me 300m² e cila gjendet në Miroc dhe një park i lodrave për fëmijë me 120m². Por kjo nuk mjafton, kur dihet që as shkollat nuk kanë salla për educate fizike.

Në kuadër të PZHU dhe PRrU "Qendra" janë parapa projekte të cilat do të mundësonin krijimin e hapësirave për zbavitje, sport e rekreacion e të cilat do të mund të shfrytëzoheshin edhe nga banorët e fshatrave si:

- Plotësimi i strukturave arsimore (shkollave) me mjedise me funksion rekreativ (lulishte, kënd lodrash, terrene sportive),
- Krijimi i një hapësire për rekreacion sportiv
- Krijimin e sheshit publik, bibliotekës komunale dhe muzeut të qytetit

If referred to the requirements of the World Bank in primary and lower secondary education this criterion is met and corresponds to the number of students and education workers (1 teacher to 21.3 students, whilst in upper secondary education the number of education workers is higher). Construction of new high school with sufficient capacities and modern-day settings has improved conditions in elementary school because the school premises are exempt from the students of secondary education and they can now hold classes in two shifts and not three as it was the case before. However, these schools are missing the sports halls and knowing that the municipality still does not have the sports center. Access to school is somewhat easier for around 90% of students. The longest distance is 3 km and the municipality has no legal responsibility to provide transportation. A bit of difficulty is with the students living in Agim Ramadani settlement and those coming from rural areas and villages from neighboring municipalities.

Junik has no preschool institutions that provide services of day-care-centers and kindergartens. Preschool Education Service is organized in the premises of primary school, but this does not mean that the municipality does not need to have such institutions (especially creche/kindergartens).

Possibilities for education of persons with special physical needs do exist, but in most cases households do not send children in classes for persons with special needs.

Notes for the level of illiteracy have not been done yet as there are no statistics on the illiteracy rate.


Objects of religion: There are 12 buildings of worship in Junik, which are scattered throughout its territory. Among them are two mosques, of which the oldest mosque is located in the Çoku quarter which dates since 1570. The second mosque is the Hoxhaj quarter and it is called "Mosque of the Center." Currently in Junik there is also a newly built masjid (tekke) which was dedicated to Halveti followers (Khalwati order of Islamic Sufi). In general, these buildings meet the needs of inhabitants and also these buldings have cultural-historical.

Facilities and public premises, and places for sport, culture and recreation: The territory of Junik observed a looming shortage of cultural institutions (museums, theater, cinema, and library), institutions and facilities for sport and recreation as well as public spaces (parks, squares, etc.). Currently, residents' need for sport and recreation satisfies only sport and recreation space with 300m² located in Miroc and a toy-park for children with 120m². But that doesn't seem sufficient given that neither the schools have no facilities for physical education.

Within the UDP and URP "Center" are designated projects that will enable the creation of spaces for entertainment, sport and recreation that could be used by villagers as:

- Completion of educational facilities (schools) with recreational facilities (parks, toy corners, sport grounds),
- Creation of a space for sports recreation
- Creating a public square, municipal library and town's museum

Punimi fitues në temën "Si e shini Junikun pas 15 viteve?"



JUNIKU SOT



JUNIKU PAS 15 VITEVE

Nëse në një të ardhme të afërt projektet e tilla do të realizoheshin, kjo sadopak do të përmbush boshllëkun që ka komuna sa i përket mungesës së hapësirave publike, dhe atyre për sport e rekreacion, jo vetëm për banorët e saj por edhe për vizitorët të cilët do vizitonin Junikun meqë turizmi shihet si një potencial zhvillimi për komunën.

Varrezat: Çështja e varrezave është një çështje brengosëse e komunës për arsye se ato janë të shpërndara gjithandej, dhe nuk kanë një lokacion të dedikuar vetëm për to. PZHU ka trajtuar këtë problematikë dhe një vendim është marrë nga Kuvendi Komunal për ndarjen e mjeteve për rregullimin e infrastrukturës së varrezave. Tani pritet përpilimi i projektit dhe shpresohet që në një ardhme të afërt çështja e varrezave të zgjidhet.

Mediat lokale: Në Junik nuk ka ndonjë radio apo televizion lokal e as edhe ndonjë korrespondent të gazetave të përditshme kosovare. Prandaj, qytetarët e Junikut kryesisht informohen nga televizionet apo radiot publike dhe ato private të komunave për rreth.

Konkluzion: Gjendja sociale në Junik në aspektin e varfërisë dhe strehimit sipas treguesve të dhënë është diç më e mirë krahasuar me trendin kosovar në përgjithësi. Mirëpo migrimi, punësimi i të rinjve dhe shkalla e lartë e papunësisë dhe ofrimi i infrastrukturës sociale dhe shërbimeve përkatëse më afër qytetarit mbesin ende një sfidë e vecantë për Komunën e Junikut.



If in the near future such projects will be materialized, howsoever it would fulfill the void the municipality has regarding the absence of public spaces and those of sports and recreation, not only for its residents but also for visitors who would visit Junik as tourism is foreseen as a potential development for the municipality.

Cemeteries: The issue of the cemetery is a matter of municipal concern since those are spread out all around, and there is no site dedicated solely to that. UDP has addressed this issue and a decision is taken by the Municipal Assembly for the allocation of funds for infrastructure regulation of cemeteries. The drafting of the project is now expected and hopefully in the very near future the issue of cemetery be resolved.

Local media: In Junik there is no local radio or television or even a reporter for any of kosovar daily newspapers. Therefore, the citizens of Junik mainly get information from public and private television or radio and off from those of neighboring municipalities.

Conclusion: Social situation in Junik in terms of poverty and housing according to the indications is somewhat better-standing compared with the general trend in Kosovo. However, migration, employment of the youth, high rates of unemployment and provision of social infrastructure and related services closer to citizens remain a particular challenge for the Municipality of Junik.





TRASHËGIMIA KULTURORE

Prezenca ende e disa vlerave të trashëgimisë kulturore (me theks të vecantë kullave) është mundësi e mirë për Junikun për të zhvilluar turizmin kulturor dhe ofruar mundësi për tu ranguar në një vend të vecantë në ofertën turistike në Kosovë dhe rajon.

Sa i përket zones urbane vërehet se lista e inventarizuar ka pësuar ndryshime të theksuara ku gjysma e tyre sot nuk ekzistojnë fare. Alarmante paraqitet edhe gjendja ku prej vitit 2007 kur është bërë edhe përditësimi i parë i informatave nga lëmia trashëgimisë kulturore e deri në vitin 2010 në Junik plotësisht zhduken 3 kulla të tjera. Kjo tregon një trend ku Komuna bashkë me institucionet relevante qendrore duhet të jetë më vigjilente sa i përket gjendjes dhe trajtimit të trashëgimisë kulturore. Kjo merr përmasa më të mëdha sepse Komuna parasheh që nëpërmjet këtyre aseteve kulturore të synojë stimulimin e zhvillimit lokal.

Sa i përket zonave jashtë zonës urbane, në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj vërehet një shkatërrim i madh i bërë kryesisht gjatë luftës së fundit. Edhe pse shkatërrimet janë të mëdha dhe këto vendbanime janë gati të shpopulluara këto zona paraqesin potencial të madh të zhvillimit të turizmit bazuar në trashëgiminë kulturore dhe natyrore.

Përkundër gjithë kësaj sot ende ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i këtyre vlerave që tentojnë t'i rrezistojnë kohës dhe zhvillimeve që sjell ajo. Ruajtja e këtyre vlerave nga degradimet, shfrytëzimi i tyre në favor të zhvillimit ekonomik të komunës, promovimi i tyre paraqet një sfidë të vecantë për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të Junikut.



CULTURAL HERITAGE

The presence of yet some cultural heritage (with emphasis to Kullas) is a great opportunity for Junik to develop cultural tourism thus providing opportunities for ranking in a particular place in the tourist offer of Kosovo and the region.

As for the urban area it is noted that the inventory list has undergone significant changes where half of those do not exist today. Situating is presented alarming where since 2007, when the first update of the information in the matter of cultural heritage, by the year 2010, 3 other Kullas have completely disappeared in Junik. This shows a tendency that the municipality together with relevant central institutions should be more attentive regarding the status and the treatment of cultural heritage. It acquires bigger dimension since through these cultural assets the municipality anticipates encouragement of local development.

As for areas outside urban settlement, in Gjocaj and Jasiq, it is obvious an immense destruction occurred mainly during the very last war. Although damages are great and these settlements are almost depopulated these areas represent vast potential for tourism development based on cultural and natural heritage.

Spite of this all, there is still a significant number of these values that tend to resist the time and developments it brings. Maintaining these values from degradation, their use in benefit of municipal economic development and promoting them presents a particular challenge for future spatial development of Junik.



VLERËSIMI I GJENDJES NË KOMUNË

Shënim: Vlerësimi i gjendjes në komunë është bërë gjatë një takimi punues një ditë me gjithë ekipin punues komunal. Vlerësimi është bërë sipas fushave tematike të përcaktuara në profil. Teknika e përdorur është SWOT. Në vijim po paraqesim vlerësimin sipas fushave tematike, pasuar me vlerësimin e përgjithshëm.

PËRPARËSITË

Gjendja fiziko - gjeografike

- Pozita e mirë gjeografike me potencial natyror ende të pashfrytëzuar
- Prania e peisazheve ujore, fushore dhe malore (lumit Erenik, maja Gjevica, kullosat)
- Flore dhe faune te pasur

Gjendja socio-ekonomike

- o zhvillimi social/demografia
- Karakteri vital dhe i paepur i popullsisë Junikase (populli e re dhe e aftë për punë)
- Nivel i lartë i sigurisë dhe respektit të ndërsjellë shoqëror
- Diasporë e fortë dhe përkrahëse e fuqishme e zhvillimeve
- Qasje e lehtë në shërbimet e shëndetësisë dhe arsimit
- o zhvillimi ekonomik
- Potencial për zhvillimin e bujqësisë dhe agro-biznesit
- Potenciali pyjor
- Vetëdijësimi për zhvillim e bujqësisë dhe agro-biznesit
- Afërsia me zonat ku zhvillohet turizmi malor, historik kulturor
- Interesimi i madh i popullsisë për zhvillimin e turizmit
- Tradita në kultivimin e zejeve tradicionale (përpunimin e leshit, thurjes së rrobave tradicionale, qëndisjes)
- Nivel i kënaqshëm i bashkëpunimit mes sektorit publik-privat

Infrastruktura fizike dhe shërbimet publike

- Qasje e lehtë në infrastrukturën rrugore
- Lidhjet e jashte rrugore (në rrugë regjionale) në gjendje relativisht të mirë
- Burime të mjaftueshme të ujit dhe furnizimi i mirë me ujë të pijes

Shfrytëzimi i tokës/vendbanimet dhe banimi

- Dendësia relativisht e ulët e ndërtimit në zonën urbane
- Shtirirje policentrike të lagjeve (sipas PZHU)
- Hapësira ende të lira për zhvillim të ardhshëm

Mjedisi, peisazhet dhe zonat e rrezikuara nga ndotja, degradimi dhe fatkeqësitë natyrore

- Jo shumë ndërtime pranë shtratit të lumit
- Nuk ka aktivitete ndotëse industriale
- Prezencë e peisazheve lumore, malore, fushore
- Lloje relikte të florës dhe faunës me vlera shkencore dhe farmaceutike
- Resurse natyrore me potencial zhvillimi turistik

Trashëgimia kulturore

- Interesim i lartë i qeverisë dhe banorëve për zhvillimin dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore
- Lokacion i njohur për trashëgimi kulturore - kullat, mullinjtë, vajavicat
- Vend historik - Kuvendi i Junikut

Sistemi i planifikimit hapësinor (aspekti organizativ)

- Staf i ri dhe i motivuar për njohuri të reja dhe avancim
- Përkrahje politike për të zhvilluar këtë sektor

SITUATION ASSESSMENT IN MUNICIPALITY

Note: Situation assessment of the municipality is brought during a one-day working meeting with all municipal working teams. The assessment is made by thematic areas specified in the profile. The technique used is the SWOT method. Below is presented the assessment by thematic areas, followed by an overall assessment.

STRENGTHS

Physical-geographical situation

- Good geographical position with the natural potential still untapped
- The presence of water, lowland and highland landscapes (Erenik River, Gjevica Peak, pastures)
- Abundant flora and fauna

Social and economic situation

- o social development/demographics
- Vital and uncompromising character of population of Junik (young and vital for work population)
- High level of security and mutual social respect
- Well-standing and development supporting Diaspora
- Easy access to health and education services
- o economic development
- Capacity for the development of agriculture and the agro-business
- Forestry potentials
- Awareness on the development of agriculture and agro-business
- Proximity to the areas of mountain, cultural and historic tourism
- Great interest of population for the development of tourism
- Tradition in cultivation of traditional crafts (wool processing, weaving of traditional garments, needlework)
- Satisfactory level of cooperation between public and private sectors

Physical infrastructure and public services

- Easy access to road infrastructure
- Relatively good links to external roads (regional road)
- Sufficient water resources and good supply of drinking water

Land use/ settlements and residential dwellings

- Relatively low density of constructions in urban area
- Polycentric layout of neighborhoods (according to UDP)
- Still unbound spaces for future developments

Environment, landscapes and areas vulnerable to pollution, degradation and natural disasters

- Not many buildings near the riverbank
- There are no polluting industrial activities
- Presence of river, mountain and field landscapes
- Relic species of flora and fauna with scientific and pharmaceutical values
- Natural resources with potentials of tourism development

Cultural heritage

- Very high interest of the government and residents for the development and promotion of values of cultural heritage
- Well known location for cultural heritage - Kullas, mills, wool pressers
- Historical site – Kuvendi i Junikut (the Assembly of Junik)

Spatial planning system (organizational aspect)

- Young and motivated personnel for new cognitions and advancement
- Political support in developing this sector

MUNDËSITË

Gjendja fiziko-gjeografike

- Ndërlidhja me shtetet fqinje

Gjendja socio-ekonomike

- o zhvillimi social/demografia
- Burimet njerëzore, mosha e re e popullsisë dhe aktive në punë
- Projektet në realizim e sipër mundësi për të përmirësuar shërbimet në arsim dhe shëndetësi
- Përkushtimi i qeverisjes vendore në të gjitha nivelet për të prodhuar programe zhvillimi për Junikun dhe promovimin e tij në rajon e më gjerë o zhvillimi ekonomik
- Potencial për zhvillimin e bujqësisë dhe agrobiznesit si dhe ndërmarrjeve agro-përpunuese
- Mundësi për ngritjen e pemishteve intensive
- Sipërfaqet e punëshme dhe potencial i mjaftueshëm ujqor për ujitjen e tokave
- Potencial për zhvillim të pylltarisë dhe blegtorisë
- Potencial për zhvillimin e energjisë alternative (hidrocentralet, biomasa, etj)
- Resurset natyrore dhe kulturore e historike potencial për zhvillimin e turizmit dhe hotelarisë

Infrastruktura fizike dhe shërbimet publike

- Mundësi për kyçjen në rrugë regjionale dhe atyre me lidhje tejkufitare
- Mundësi e përfitimit nga projektet mbi bashkëpunimin ndërkomunal me Gjakovën e Deçanin
- Zhvillimi i infrastrukturës së këmbësorëve brenda dhe jashtë zonës urbane (ajo jashtë zonës urbane mund të shfrytëzohet edhe për sport, rekreacion për banorët, turistët vendor dhe ndërkombëtar)
- Mundësi e qasjes në transportin hekurudhor poqese zhvillohet linja hekurudhore Gjakovë-Klinë

- Mundësi komunikimi të shpejta përmes linjave ajrore poqese realizohet projekti i Aeroportit të Kukesit apo dhe ai i Gjakovës
- Mundësi e përmirësimit të furzinimit me ujë meqe ka burime ujore me potencial zhvillimit
- Mundësitë e shfrytëzimit të fondeve të donatorëve për shtrirjen e rrjetit të kanalizimit
- Mundësi e shfrytëzimit të fondeve për zhvillimin e studimeve për energji alternative
- Zgjerimi i rrjetit të telekomunikimit dhe internetit do të mundësojë komunikim më të shpejtë dhe qasje më të lehtë në informata
- Menaxhim më i mirë i mbeturinave me marrjen përsipër të kompetencave nga komuna për kryerjen e këtij shërbimi (sidomos të grumbullimit)
- Shfrytëzimi i tokës/vendbanimet dhe banimi
